Buletini i Shkencave Gjeologjike

1/2021

Buletin of Geological Sciences

Buletini i Shkencave Gjeologjike
1/2021
Buletin of Geological Sciences

Bordi Editorial

Dr. Arben Pambuku-Kryeredaktor
Prof. Dr. Kujtim Onuzi-Sekretar
Prof. Ass. Dr. Veip Gjoni-Anëtar
Prof. As. Dr. Rexhep Koçi-Anëtar
Prof. Dr. Vilson Silo-Anëtar
Prof. Dr. Irakli Prifti-Anëtar
Prof. Ass. Dr. Agim Mësonjësi-Anëtar
Ing. Elisa Prendi-Redaktore Përgjegjëse

ISSN 0254-5276

Buletini i Shkencave Gjeologjike
1/2021
Buletin of Geological Sciences

Korrelime gjeologjike të zonës kufitare Kosovë-Shqipëri
(Plansheti K-34-66-c, Morini, shkalla 1:50 000)
[Geological correlations of Kosovo-Albania border area
(Sheet K-34-66-c, Morini, scale 1:50 000)]
Alaudin Kodra, Vesel Hoxha, Sabri Avdullahi ..... 7 [21]

Gjeologjia dhe petrologjia e kompleksëve ofiolitike të Shpat-Kutermanit dhe Shebenik-Pogradecit
[Geology and petrology of the ophiolitic complexes of the Shpat-Kuterman and Shebenik-Pogradec]
Kujtim Onuzi, Dashamir Gega, Friedrich Koller ..... 25 [35]

Korrelime gjeologjike të zonës kufitare Shqipëri-Kosovë,
Plansheti K-34-78-A, shkalla 1:50 000)
[Geological correlations of Kosovo-Albania border area
(Sheet K-34-78-A, Shishtaveci, scale 1: 50 000)]
Vesel Hoxha, Alaudin Kodra, Sabri Avdullahi ..... 45 [61]

Perspektiva krommbajtëse e vendburimit të Bulqizës,
në veri të luginës së Vajkalit
[Chrome-bearing perspective of the Bulqiza deposit,
north of Vajkal valley]
Dashamir Gega ..... 65 [79]

KORELIME GJEOLOGJIKE TË ZONËS KUFITARE KOSOVË - SHQIPËRI (PLANSHETI K - 34 - 66 - C, MORINI, SHKALLA 1 : 50 000)

Alaudin Kodra*, Vesel Hoxha*, Sabri Avdullahi **

Abstrakt

Studimi i korrelimeve gjeologjike të zonës kufitare në fjalë sqaroi në masë mjaft të mirë problematikën gjeologjike që reflektohej në harta të shkallëve të ndryshme, të përpiluara për rajonet në të dy anët e kufirit.

Formacionet e datuara si të Permian - Triasikut (P-T) në hartën gjeologjike në shkallë 1:100 000 të planshetit Prizren K-34-66, Menkoviq et al., (1982) apo të datuara si të Paleozoikut të Sipërm në hartën gjeologjike në shkallë 1 : 50 000 të Dickmayer, Hild (2004), në pjesën më të madhe janë të moshës së Ordovikian - Silurianit.

Formacionet rreshporo - kuarcite të Ordovikian - Silurianit mbivendosen mbi formacionet karbonatike të maleve të Koritnikut. Balli i këtij rafshi përfaqëson një nga lineamentet më të rëndësishme të zonës. Edhe marrëdhëniet e formacioneve rreshpore-kuarcite të rajonit të Sharrit me formacionet karbonato - rreshpore - radiolaritike në cepin JL të planshetit janë të natyrës mbulesore. Është bërë një rajonizim i ri tektonik, esencialisht i ndryshëm nga ato të mëparshmit. Njësia e Sharrit e veçuar për herë të parë në këtë studim është e mbivendosur tektonikisht mbi Njësinë e Koritnikut në Veri dhe mbi Njësinë e Abdavit në Juglindje.

Njësia e Koritnikut në territorin e Kosovës korrelohet shumë mirë me Njësinë e Gjallicës në territorin e Shqipërisë. Dallime vërehen vetëm në përfaqësime të ndryshme litologjike të Ladinianit si dhe në shkallën më të lartë të metamorfizmit të karbonateve në territorin e Kosovës. Formacionet ofiolitike bazalto - radiolaritike-dhe të melanzhit "blloqe në matriks", korrelohen në të dy anët e kufirit. Në territorin e Shqipërisë mes fshatrave Bardhoc dhe Morinë, formacioni basalt-radiolarit me interes hulumtimi për mineralizime sulfide masive të bakrit nuk zhvishet pothuajse fare në sipërfaqe (duke u maskuar tektonikisht apo nga mbulesa të depozitimeve më të rej`a), në territorin e Kosovës mes Vërmicës dhe Shkozës ky formacion zhvishet gjerësisht dhe paraqet rëndësi të dorës së parë për kërkimin e mineraleve të mësipërm.

Në të ardhmen duhet të vendosen punime të rregullta kërkim-rilevimi në shkallë 1:25 000, të cilat do të sqarojnë plotësisht jo vetëm gjeologjinë tepër të komplikuar të rajonit, por edhe mineralmbajtjen e tij, ku vend të parë zënë mineralizimet masive sulfide të bakrit dhe mineralizimet radioaktive.

Fjalë kyç: *Sharri, Abdavi, Koritniku, paleozoi, Muhurr-Çaja, tektonikë, konodonte.*

Qëllimi

Qëllimi i studimit ishte realizimi i korrelimit të formacioneve gjeologjike të zonave kufitare në fjalë, të sqaronte problematikën gjeologjike që reflektohej në harta të shkallëve të ndryshme të përpiluara për rajonet në të dy anët e kufirit si dhe, të ndërtonim një rajonizim te ri tektonik, bazuar në rezultatet korreluese.

Hyrje

Informata historike dhe literaturë të studimeve regjionale në rajonet e planshetit K-34-66-C mund të merren në shpjeguesin e planshetit të Prizrenit në shkallë 1:100 000 (K-34-66) të autorëve Karoviq et al. (1982 etj), dhe në monografinë "Gjeologjia e Kosovës" (Elezaj, Kodra 2008), ndërsa për pjesën tjetër, në territorin e Shqipërisë në doktoratën e Kodra A. (1986) dhe në monografinë "Gjeologjia e Shqipërisë" (Xhomo etj, 2002) etj. Informata më të detajuara që lidhen me kërkime të specializuara për minerale të ndryshme në të dy anët të kufirit mund të gjenden në arkivat gjeologjike të Prishtinës dhe Tiranës. Në aspektin shkencor,

**UPT, IGJEUM, Tiranë; **Un. Isa Boletini, Fakulteti i Gjeoshkencave, Mitrovicë*
e-mail: vesel.hoxha@gmail.com; veselhoxha52@yahoo.com

për problemet fondamentale të stratigrafisë, tektonikës dhe magmatizmit mund të themi se :

- Mosha e formacioneve të vjetra të Ordovikianit, Silurianit dhe Devonianit të rajoneve të Sharrit është trajtuar në harta të ndryshme me moshë të ndryshme: Karoviq et al. (1982) i trajtojnë si të Permo - Triasikut të pandarë. Knobloch, Legler (2006) i trajtojnë pjesërisht si të Paleozoikut të Sipërm, pjesërisht si të Paleozoikut të Poshtëm. Elezaj, Kodra (2008) e trajtojnë drejt moshën e këtyre formacioneve, por pa paraqitur hartë gjeologjike të mirëfilltë.

  Studiuesit e mësipërm, strukturat gjeologjike të formacioneve Paleozoike - Mesozike të rajonit të Sharrit dhe Koritnikut i interpretojnë të qeta, monoklinale, me shtrirje stratigrafike të njëpasnjëshme të formacioneve karbonatike Triasike të Koritnikut mbi rreshpet Paleozoike të Sharrit. Në të vërtetë, në korrelacion edhe me të dhënat nga Shqipëria, formacionet rreshpore të Paleozoikut të Poshtëm të Njësisë së Sharrit, paraqiten të branisura mbi formacionet karbonatike Triasike të Njësisë së Koritnikut. Formacionet e kësaj të fundit nuk ndërtojnë strukturë monoklinale, por një antiklinal asimetrik.
- Në rajonet JL, në cepin më JL të planshetit rreshpet e Ordovikian-Silurianit të Njësisë së Sharrit mbivendosen tektonikisht mbi formacionet Palezoike karbonatike-rreshpore të Njësisë së Abdavit (vazhdimi VL i Njësisë tektonike të Malësisë së Korabit në Shqipëri).
- Formacionet oqeanike të Vermicë-Shkozës në hartat e mëparshme janë trajtuar si melanzh i Jurasikut. Elezaj, Kodra 2008 veçojnë formacionet e melanzhit të Jurasikut të Mesëm?-të Sipërm nga formacioni vullkano-sedimentar bazalt-radiolarit i Triasikut (βT2-J1) si vazhdim direkt i bazalt-radiolariteve të vendburimit të bakrit masiv sulfid të Gjegjanit.

Të dhëna të përgjithshme gjeologjike

Në rajonin e Sharr-Koritnikut dhe Vermicës veçohen një sërë njësish tektonostratigrafike: Në mikroblokun kontinental Korab-Pelagonian, në territorin e Kosovës njësohen Njësitë e Sharrit, Abdavit dhe Koritnikut, të cilat korrelohen përkatësisht me Njësitë e Kollovozit, Malësisë së Korabit dhe të Gjallicës në Shqipëri (Fig. 1, 2, 3, 4 dhe 5).

Në planshetin K-34-66-C, në territorin Shqiptar përhapet edhe njësia e Muhurr-Çajës, e cila nuk takohet në territorin e Kosovës.

Në përshkrimin e stratigrafisë, tektonikës dhe magmatizmit për çdo njësi do të japim të dhënat për territorin e Kosovës dhe korelacionet përkatëse me formacionet dhe strukturat njëmoshore të territorit shqiptar.

NJËSIA E SHARRIT

Njësia e Sharrit ka përhapje shumë të gjerë në rajonet e Komunës së Dragashit (Sharrit). Ajo korrelohet shumë mirë me Njësinë e Kollovozit në Shqipëri.

Stratigrafia

Paleozoiku

Ordovikian - Siluriani (O - S)

Formacionet më të vjetra në Njësinë e Sharrit janë ato të Ordovikian - Silurianit. Përfaqësohen nga kuarcite, ranorë kuarcorë, filite, rreshpe kuarc seiricitike, klorit sericitike etj.

Nivelet më të vjetra zhvishen në pjesën VP të njësisë në fshatin Orçushë dhe për rreth, dhe në pjesën JL në malësitë e Bitir - Radeshës dhe për rreth. Kemi të bëjmë me prerje, ku mbizotërojnë kuarcitet dhe ranorët kuarcorë të ndërshtresëzuar rreshpe me kuarc sericitike. Kuarcitet përmbajnë 95-97 % SiO_2, ndërsa ranorët janë kuarc-feldshpatikë, kokërrimët. Kuarcitet dhë ranorët kuarcorë të Orçushës, etj., në pjesën VP të Njësisë së Sharrit korrelohen dhe janë vijueshmëri direkte e kuarciteve dhe ranorëve kuarcorë të Njësisë së Kollovozit në Shqipëri, që ndiqen pothuaj pa ndërprerje në fshatrat Pakish e Kosharish në VL deri në Nimçe-Kollovoz etj., në JP. Dallimi ndërmjet tyre është vetëm me faktin se formacionet e poshtme të Njësisë së Sharrit vendosen tektonikisht mbi formacionet e Njësisë së Koritnikut, në territorin Shqiptar; formacionet e Njësisë së Kollovozit vendosen

Fig.1 *Harta skematike e vendndodhjes së planshetit K-34-66-C, në zonën kufitare Kosovë - Shqipëri.*



Fig. 2 *Skema tektonike e rajonit të planshetit K-34-66-C, në shkallë 1:50 000, pjesë e bllokut kontinental Korab-Pelagonian.*

tektonikisht kryesisht mbi formacionet e Njësisë së Çajës. Kjo e fundit nuk zhvishet në territorin e Kosovës, duke u maskuar nga mbivendosja e Njësisë së Sharrit direkt mbi njësinë e Koritnikut.

Mbi pakon e kuarciteve dhe ranorëve kuarcorë e ndërshtresëzuar me rreshpe kuarc-sericitike shtrihen rreshpe klorit-sericitike, kryesisht ngjyrë të blertë, që në pjesën e poshtme shoqërohen me rreshpe të zeza argjilo-sericitike. Trashësia e rreshpeve klorit-sericitike të blerta është mbi 150 m.

Mes rreshpeve klorit-sericitike të blerta takohen shkëmbinj vullkanikë dhe subvullkanike acide-alkinore (ignimbrite riolitike dhe riolite). Këta shkëmbinj do të përshkruhen në paragrafin e magmatizmit.

Silurian - Devoniani (S - D)

Formacionet e Silurian-Devonianit kanë përhapje të kufizuar. Ato shtrihen mbi formacionet e Ordovikian-Silurianit me kufij jo shumë të qartë në terren. Vendpërhapjet e tyre janë kryesisht në rajonin mes Kollovozit dhe Oreshkës në Njësinë e Kollovozit etj.

Në territorin e Kosovës veçimi i formacioneve të Silurian-Devonianit kërkon punime të rregullta rilevimi, por në bazë të interpretimeve tona mendojmë se këto formacione, do të veçohen në rajonin në mes të Plavës dhe Biljaqit. Përgjithësisht kemi të bëjmë me rreshpe argjilore sericitike të zeza dhe rreshpet klorit-sericitike me ndërshtresa të holla karbonatike mes tyre dhe që ndërpriten nga damarë të llamprofireve.

Në rajonin e fletës tonë argumentimi faunisitk mungon. Më në Jug, në rajonin e Sarakolit, në shtresat e gëlqerorëve është takuar konodonti i aparatit *Kockelella variabilis*, që është formë tipike e Siluranit më të Sipërm, Katit Pridolian.

Përveç kësaj në nivelet më të sipërme të prerjes takohen gëlqerorë me krionoide, ku përcaktohet forma *Scyphocrinites sp.* Në këto gëlqerorë krinoidalë është dokumentuar edhe prania e konodonteve *Ozarcodina excavata excavata, O. remscheidensis remscheidensis etj. Përhapja e tyre është në Silurianin e S*ipërm-Devonianin e Poshtëm. Në pjesën më të sipërme të prerjes, në ndërshtresat gëlqerore janë evidentuar konodontet *Ancyrodelloides cf. delta de Ozarcodina confluens* që i përkasin moshës Lohkoviae (Devonianit të Poshtëm).

Devoniani i Sipërm (D_3)

Ka përhapje tepër të kufizuar në rajonin e fletës K-34-66-C, vetëm në territorin e Shqipërisë. Ai takohet në Perëndim të fshatit të Borjes, mes këtij të fundit dhe fshatit të Oreshkës. Kemi të bëjmë me një formacion ranoro-konglomeratik, që ngjason tepër me ranoro-konglomeratët e kuqëremtë "Verrucano" të Permo-Triasikut të Poshtëm. Në mes të ranorëve



Fig. 3 *Profili gjeologjik A- B, i ndërtuar në zonën kufitare Kosovë - Shqipëri, sipas drejtimit veriperëndim - juglindje.*

takohen ndërshtresa të holla gëlqerorësh biomikrosparitikë, në të cilat janë evidentuar konodontet *Palmatolepsis minuta minuta, P. cf. triangularis* etj., që i përkasin Devonianit të Sipërm. Në përbërje të konglomeratëve kemi zaje të kuarcit, kuarciteve, ignimbriteve, copa rreshpesh, etj. Matriksi është ranoro-alevrolitik me përmbajtje të njëjtë të zajeve. Trashësia e konglomerato-ranorëve është e pa qartë, por pa dyshim është më shumë se 30 m. Pozicioni gjeologjik i ranoro-konglomeratëve të Borjes është jo i qartë në terren, për shkak të mbulesës Kuaternare që shtrihet mbi to në Perëndim, JL dhe Lindje të tyre. Në Veri, marrëdhëniet me formacionin rreshpor të Ordovikian-Silurianit janë tektonike. Fakti që në Oreshkë, në Perëndim të ranoro-konglomeratëve zhvishet formacioni i rreshpeve të zeza të Silurian-Devonianit, na shtyn të mbështesim interpretimin që konglomerato-ranorët e Borjes shtrihen mbi këto të fundit. Xhomo et al. (2002, 2005) konglomeratët e Borjes i kanë përfshirë së bashku me rreshpet e Silurian-Devonianit në një formacion të pa ndarë. Në pjesën tjetër të territorit të fletës nuk evidentohet formacion analog. Ne vrojtuam në terren hartografikimet e konglomeratëve të paraqitura në përroin e Xërxës dhe në Jug të Dragashit (Karoviq etj, 1982, Knobloch, Legler, 2006). Nga vrojtimi jonë rezultoi se, nuk kemi të bëjmë me konglomerate, por me ignimbrite mes rreshpeve të Ordovikian-Silurianit. Jashtë territorit të fletës tonë, në territorin e Maqedonisë, në malësitë e Sharrit, në qafën e Kadisë dhe në mes Bradoshavcit dhe Kara Nikollës në Jug, konglomerato-ranorë me ndërshtresa të holla gëlqerorësh pllakorë, në bazë të tentakuliteve evidentohen si të Devonianit (Gjergjeviq, 1961). Ato shtrihen mbi formacionet rreshpore dhe kuarcitike të Palezoikut të Poshtëm.

Mesozoiku (Mz)

Formacionet e Mesozoikut kanë përhapje të kufizuar vetëm në Njësinë e Sharrit. Kemi të bëjmë me formacione kabonatike të moshës Triasike, që kontaktojnë tektonikisht me formacionet e Ordovikian-Silurianit.

Dalje të formacioneve të Triasikut takohen në Veri të fshatrave Bllacë e Brut si



Fig. 4 *Harta gjeologjike e zonës kufitare Kosovë - Shqipëri, plansheti Morini*

dhe mes fshatrave Xërxë, Renc dhe Koshavc. Një dalje e kufizuar takohet mes Dragashit dhe Kukalanit. Kemi të bëjmë me gëlqerorë të mermerizuar. Në pjesën e poshtme, në mjaft dalje kemi të bëjmë me gëlqerorë dhe dolomite të kuqërremtë, në disa raste me ndërtim nyjor (Xërxë). Këto nivele korrelohen mirë me nivele të Anizianit të prerjeve në Malin e Koritnikut. Në pjesën e sipërme kemi gëlqerorë të mermerizuar, ngjyrë gri në të bardhë. Paraqiten shtresë trashë deri masive dhe korrelohen me gëlqerorët e mermerizuar të Malit të Koritnikut, që i përkasin kryesisht Triasikut të Mesëm (Ladinian) dhe Triasikut të Sipërm. Format e zhveshjeve sipërfaqësore të gëlqerorëve janë pak a shumë izometrike. Nuk është i qartë pozicion i këtyre gëlqerorëve në marrëdhëniet me formacionet terrigjene të Ordovkian-Silurianit. Pa dyshim që marrëdhëniet janë tektonike. Kemi dy interpretime në lidhje me daljet e gëlqerorëve:

1. Masa karbonate, me marrëdhënie tektonike tip shkarje normale, kundër normale etj. me formacionet terrigjene Paleozoike.
2. Masa karbonate, që përfaqësojnë dritare tektonike të formacioneve të Njësisë së Koritnikut mes formacioneve terrigjene të Ordokivian - Silurianit, të branisura tektonikisht mbi to.

Janë të nevojshme rilevime të detajuara gjeologjike, shoqëruar me studime tematike për ti dhënë zgjidhje këtij problemi.

Fig. 5. *Shpjeguesi i hartës "Korelime gjeologjike të zonës kufitare Kosovë-Shqipëri", Shkalla 1:50 000, Plansheti K-34-66-C, Morini.*

Pliocen Kuaternari dhe Kuaternari (N_2- Q_p dhe Q)

Sedimente copëzor-mëdha të Pliocen-Pleistocenit (N_2 - Q_p)

Kemi të bëjmë me sedimente liqenore, që përhapen mes Dragashit e Shahinovcit, në Veri të Buzës, në gropën e Llapushnikut si dhe në hapësirën mes Vranishtit dhe Mlikës. Ato shtrihen mbi formacionet rreshpore dhe ignimbritet e Ordovikian-Silurianit. Përfaqësojnë sedimente poligjenetike. Disa autorë i konsiderojnë të moshës së Pliocenit (Markoviq et al. 1958), të tjerë të Pleistocenit (Cvijiq, 1911). Ne mendojmë, se këto sedimente janë të njëkohëshme me ato të Pliocen-Pleistocenit, anologe me mjaft depozitime të ngjashme në rajone të Kosovës dhe të Shqipërisë etj. Përfaqësohen nga blloqe të shumta me matrix rëre dhe argjila. Trashësia deri 40 m.

Materiale morenore (glaciale dhe fluvioglaciale) Plestocen (Q_p)

Gjatë Pleistocenit pjesët e larta të rajonit tonë ashtu si pjesa më e madhe e malësive të Sharrit dhe të Korabit pushtohen nga akullnajat. Cirqet morenore me blloqe janë me përmasa të ndryshme, shoqëruar me material të pa asortuar. Në malet e Radeshës evidentohen cirqe të shumta morenore. Depozitime morenore takohen edhe në lumin e Plavës, në Brodeshavc, Dragash, Rrapçë e Poshtme etj. ku përzihen me depozitime shpati, etj.

Depozitime të Holocenit (Q_h)

Në depozitimet e Holocenit veçohen proluvione dhe deluvione. Proluvionet janë tepër të përhapura, gjë që kushtëzohet nga përhapja e madhe e përrenjve si Plava - Orgjosti me të gjithë degët e tij, Përroi i Brodit, i Restelicës etj. Deluvionet takohen në shpatet e maleve dhe në rrëzë të tyre arrijnë trashësi disa metra. Përbërja e formimeve të më sipërme reflekton ndërtimin gjeologjik të rajoneve prej të cilëve shplahen këto formime.

Tektonika

Njësia tektonike e Sharrit ka marrëdhënie tektonike me Njësinë e Koritnikut në VP, me Njësinë e Muhurr - Çajës në Perëndim dhe me njësinë e Abdavit në JL. Formacionet Mesozoike-Paleozoike të Njësisë së Muhur-Çajës, mbyllen tektonikisht brenda territorit Shqiptar dhe në territorin e Kosovës, Njësia e Sharrit mbivendoset direkt mbi Njësinë e Koritnikut. Vetë

Njësia e Sharrit përfaqëson në tërësi një strukturë sinklinale me formacione më të vjetra ranoro-kuarcite, etj. në pjesën perendimore (Kollovoz-Oreshkë) dhe lindore (rrjedhja e mesme e lumit të Brodit, malet e Radeshës, dhe Plajnikut). Në qendër të strukturës sinklinale janë formacionet rreshpore filitike të Dragashit, Shahinovcit, Rencit etj., shoqëruar me ignimbrite në mes tyre. Përveç rrafsheve kryesore të mbivendosjes së Njësisë së Sharrit mbi njësitë e tjera kufizuese, në brendësi të Njësisë së Sharrit evidentohen një sërë shkëputjesh tektonike, sikundër janë shkëputjet mes formacioneve Paleozoike dhe atyre Triasike, etj.

Magmatizmi

Formacionet magmatike kanë përjapje të gjërë në Njësinë e Sharrit (Kollovozit). Ata përfaqësohen nga shëmbinj magmatikë vullkanikë e subvullkanikë dhe nga shëmbinj intruzivë dhe dajkorë.

Shkëmbinjtë vullkanikë dhe subvullkanikë

Përhapen gjerësisht në rajonet kufitare Shqipëri - Kosovë. Vendpërhapjet me të rëndësishme janë ato të Vranishtit deri në Glloboçicë në territorin Kosovar dhe të Borjes, Shtrezit etj., në territorin Shqiptar. Veçohen vullkanite bazikë dhe acide. Vullanitet bazike përfaqësohen nga bazalte, porfire bazaltike, gabrodiabaze, etj., të cilat për shkak të metamorfizmit janë shndruar në porfiritoide dhe rreshpe të gjelbra, kanë teksturë masive deri rreshpore, mikrostrukturë bajamore, strukturë ofiolitike, poikiloofitike, porfire etj. Përbëhen nga plagjioklazi bazik dhe diopsid - augiti. Si aksesorë takohen titanomagnetiti, apatiti, etj. Në sajë të ndryshimeve takohen klorit, albit, epidot, etj. Analizat kimike të vullkaniteve bazike evidentojnë përmbajtje të rritura të TiO2. Ato rezultojnë muzherite, havaite dhe toleite të mbingopura.

Shkëmbinjtë vullkanikë dhe subvullkanikë acidë

Kanë përhapje të gjerë në të dy anët e kufirit Kosovë-Shqipëri. Në territorin e Kosovës takohen në Vranisht, Mlikë, Globoçicë e Krushevë. Në anën Shqiptare takohen në Borje, Shtrez, Kollovoz etj.

Përgjithësisht kemi shkëmbinj vullkanikë, ngjyrë hiri, hiri-vjollcë, hiri-gjelbër, etj. me teksturë masive, që ndërtojnë pjesë të mesme të daljeve vullkanite dhe lloje eutaksike, me ndërtim rreshpor që ndërtojnë pjesët anësore. Kemi të bëjmë me shkëmbinj ignimbritë riolitikë deri në riolite për faciet subvullkanite (të quajtura porfire kuarcore në literaturën e vjetër).

Edhe disa dalje të vogla të trajtuara si konglomeratë në mes rreshpeve në përroin e Xërxës, Kukalanës, etj, përfaqësojnë ignimbrite.

Struktura është porfire me masë themelore vitroklastike mikrofelzitike. Përbëhen nga kuarci, albi-oligoklazi, feldshpati kaliumor. Rrallë takohen copa xhami vullkanik acid, copa lavore acide dhe rreshpe kuarc-sericit-grafitike etj.

Të dhënat e anlizave kimike tregojnë se ato janë shkëmbinj acidë normalë, të tipit riolitik, të mbingopur në SiO2 dhe përmbajnë alkalinë,

Në pjesën e poshtme të vullkaniteve acide-alkalinore takohen trahiriolite felzitike. Mes ignimbriteve takohen edhe dajka të shkëmbinjve ortofirë, ku përmbajtja e K_2O arrin deri 11,3%.

Shkëmbinjtë intruzivë

Në shkëmbinjtë intruzivë që takohen në Njësinë e Sharrit (Kollovozit) veçohen: monzonitet, monzonit-sienitet, granosienitet, granodioritet si dhe seria e llamprofireve.

• *Monzonit sienitet granosienitet, granodioritet, etj*

Shkëmbinjtë e mësipërm dhe lloje të afërta me to takohen gjerësisht përgjatë rrugës Kukalanë-Dikancë deri në Veri të Brodit, në VL të fshatit Radeshë, etj. Këto shkëmbinj intrudojnë rreshpet e Ordovkian-Silurianit, që përhapen në pjesën e sipërme të prerjes terrigjene të Paleozoikut në Njësinë e Sharrit. Edhe në daljet e ignimbriteve-porfireve kuarcore të Vranishtit dhe Mlikës evidentohen dalje të monzonit dioriteve, përmasat e të cilave për shkak të mbulesës pyjore nuk mund të saktësohen. Kontaktet e monzonit-sieniteve dhe dioriteve me rreshpet e Silurian-Devonianit në shumë vende janë të tektonizuara. Megjithatë, formimi i glaukofanit dhe albitit në kontakt të dioriteve

dhe monzoniteve me rreshpet, dëshmon për marrëdhënie mes tyre. Dukuritë e kataklazmit dhe millonitizimit janë realizuar gjatë ngjarjeve tektonike. Në mjaft raste vërehet një transformim i dukshëm metamorfik, ku nga mineralet dominon sericiti dhe kuarci. Në raste të tjera proceset metamorfike janë të shprehura më dobët. Në përbërjen minerale marrin pjesë në sasi të ndryshme: albiti, piroksen monoklin, biotiti, sasi të ndryshme ortoklazi dhe kuarci.

Përgjithësisht në shkëmb mbizotëron masa feldshpatike e ndryshuar (albitizuar). Edhe mineralet me ngjyrë janë mjaft të ndryshuar. Në vartësi të përqindjes së SiO2, K2O, etj, shkëmbi varion nga monzonit e monzonit-sienit deri në sienit e grano-sienit, etj.

• *Shkëmbinjtë e serisë llamprofire*

Shkëmbinjtë llamprofirë takohen gjerësisht përgjatë rrugës pranë fshatit Dikancë, etj. Veçohen kersantite (kamptonite), spesartite, etj. Në mjaft raste ato mund të evidentohen në vogezite. Në përbërjen e tyre marrin pjesë: biotiti, diopsidaugiti, amfiboli, plagjioklazi, rrallë mikroklini. Si aksesorë takohen: sfeni, apatiti, etj. Plagjioklazet parqiten tepër të ndryshuara. Vogezitet, kamptonitet, etj., takohen në lidhje të ngushtë me monzonitet, monzonit - sienitet, grano-sienitet, etj. Ato paraqiten në trupa me përmasa qindra metra në shtrirje dhe në relacion me monzonitet, etj., janë më pak të reja. Të dhënat për moshën e shkëmbinjve të serisë llaprofire janë të varfëra. Dy përcaktime të kryera shumë vite më parë për kersantitet e Njësisë së Kollovozit japin moshë 241, 512 milion vjet, gjë që i korrespondon Triasikut të Mesëm-të Poshtëm. Përcaktimet janë bërë me metodën e Kalium-Argonit.

NJËSIA E ABDAVIT

Formacionet gjeologjike të Njësisë së Abdavit kanë përhapje të kufizuar në cepin JL të fletës K-34-66-C, në Verilindje të fshatit Brod. Në fletën topografike K-34-78-A, etj., këto formacione kanë përhapje të gjerë.

Stratigrafia

Paleozoiku (Pz)

? Devoniani (D)

Formacionet e ?Devonianit përfaqësohen nga gëlqerorë pllakorë me silicorë, ngjyrë gri, gri të errët, të cilët në taban të tyre kanë rreshpe silicore dhe argjilo - silicore me ngjyrë të kuqe, vjollcë, etj. Më në Jug në territorin e planshetës K-34-78-A përhapen gjerësisht në rrjedhën e sipërme të lumit të Brodit, kryesisht në faqen e djathtë të tij. Në hartën gjeologjike të Kosovës në shkallë 1:100 000 të vitit 1975 (Anonim 1975), gëlqerorët pllakorë me silicorë trajtohen si të Kretakut të Sipërm (Cenomanian), ndërsa formacionet e tjera si rreshpe dhe filite të Paleozoikut. Në hartën gjeologjike të fletës së Prizrenit K-34-66 (shkalla 1:100 000) (Karoviq et al., 1982) ky cep interpretohet si i moshës Paleozike me marrëdhënie tektonike me formacionet Paleozoike të Njësisë së Sharrit (Njësia e Sharr-Koritnikut sipas Karoviq et al.) Në hartën gjeologjike të fletës së Gostivarit K-34-78 (shkalla 1:100 000) formacionet që janë në vazhdim trajtohen si të moshës moshës Triasike (Petovski, Sikoshek, 1982). Në kuadrin e projektit, provëmarja e kryer për konodonte dhe mikrofacie në gëlqerorët pllakorë të rajonit nuk dha rezultate pozitive. Mbështetur në të dhënat për rajonin e Restelicës si dhe korrelacionit me gëlqerorët analogë të Njësisë së Malësisë së Korabit, prerjet e rajonit të Brodit i kemi interpretuar si të moshës së Devonianit. Meqenëse këto formacione do të trajtohen gjerësisht në studimin e planshetit K-34-77-A, nuk po ndalemi më gjatë.

Tektonika

Formacionet karbonatike-rreshpore dhe të silicorëve të Njësisë së Abdavit, që zhvishen në planshetin tonë kanë marrëdhënie tektonike me formacionet e Ordovikian-Silurianit të Njësisë së Sharrit. Në VL të fshatit Brod evidentohet qartë branisja e formacioneve të Njësisë së Sharrit mbi ato të Abdavit. Vetë formacionet karbonatike-rreshpore dhe silicore të Njësisë së Abdavit paraqesin vendosje monoklinale me rënie VP me kënde 30-35°.

Magmatizmi

Në sipërfaqen e përhapjes së formacioneve karbonatike dhe rreshpeve silicore nuk takohen formacione magmatike rrënjësore. Vetëm disa blloqe porfiritesh diabazike takohen në degën e përroit që derdhet në përroin e Brodit. Paraqiten mjaft të deformuara dhe të rreshpëzuara.

NJËSIA E MUHUR - ÇAJËS

Njësia e Muhurr-Çajës përhapet vetëm në anën Shqiptare të Kufirit.

Në rajonin e fletës K-36-66-C, Njësia e Muhurr-Çajës takohet në luginën e lumit të Lumës dhe në rrjedhën e poshtme të lumit të Plavës (lumi i Orgjosit). Në drejtimin perëndimor e verior Njësia e Muhurr-Çajës kontakton me Njësinë e Gjallicës, ndërsa në drejtimin lindor mbi të vendoset tektonikisht Njësia e Kollovozit.

Stratigrafia

Meqenëse kjo Njësi nuk përhapet në territorin e Kosovës litostratigrafinë e saj do ta japim në mënyrë të shkurtuar.

Formacionet më të vjetra janë rreshpet e Silurian-Devonianit, të cilat mbulohen nga një formacion i ranorëve arkozikë të moshës së Devonianit (Meço, 1988).

Në luginën e lumit të Lumës, prerja Permo-Triasike dhe Triasike përfaqësohet nga konglomerato-ranorë, rreshpe karbonatike, ranorë kuarcorë, kuarcite, porfitoide etj.

Pranë fshatit Nimçë, mbi rreshpet e Silurian-Devonianit me mospajtim strukturor shtrihen konglomerato-ranorë të kuqërremtë e mbi to formime flishoidale argjilo-karbonatike me trupa gabro diabazikë. Mbi to shtrihen dolomite të kuqërremta të Anizianit të Poshtëm dhe gëlqerorë të kuq nyjorë të Anizianit të Sipërm.

Tektonika

Njësia e Muhurr-Çajës në kufijtë e fletës K-34-66-C ka strukturë të ndërlikuar. Sikundër e përmendëm më sipër, në drejtim perëndimor dhe verior ajo kontakton me Njësinë e Gjallicës, ndërsa në drejtim lindor mbi të branisen formacionet e Njësisë së Kollovozit. Rrafshi i kësaj branisje ndiqet qartë në terren nga Topojani, Nimça, Cernaleva e deri pranë Pakishit, në afërsi të kufirit me Kosovën. Pikërisht, në këtë vend Njësia e Muhurr-Çajës pykëzohet tektonikisht dhe formacionet e Njësisë së Kollovozit mbivendosen drejtpërdrejt mbi formacionet e Njësisë së Koritnikut. Pra, Njësia e Muhur Çajës nuk ka përhapje në territorin e Kosovës.

Magmatizmi

Në Njësinë e Muhur-Çajës, në kufijtë e fletës K-34-66-C kanë mjaft përhapje shkëmbinjtë magmatikë.

Shkëmbinjtë magmatikë më të vjetër janë profiritoidet, që shoqërojnë rreshpet dhe ranorët në lumin e Lumës, me përhapje nga bashkimi i lumit të Orgjosit (Plavës) me lumin e Lumës dhe deri afër urës së Lojmes.

Përhapje të gjerë pranë Nimçes, poshtë ballit të branisjes së Njësisë së Kollovozit mbi Njësinë e Muhur-Çajës, kanë shkëmbinjtë subvullkanikë të llojit gabrodiabazikë. Ato paraqiten në lidhje të ngushtë me rreshpet argjilo-karbonatike të Triasikut të Poshtëm-të Mesëm. Monzonit-sienitet paraqiten në trajtë të një masivi të vogël me shtrirje VL - JPP, pranë Nimçes, në vendin e bashkimit të lumit të Orgjosit me lumin e Lumës.

Masivi monzonit -sienitik i Nimçes ndërpret qartësisht rreshpet e zeza argjilo-sericitike dhe argjilo silicorët e Silurian-Devonianit si dhe ranorët arkozikë të Devonianit, që shtrihen mbi to. Paraqiten me teksturë taksite, nga kokrizmesatarë deri në kokrizmëdha, trahitoidale, më strukturë porfire, me elementë të strukturës poikilitike. Përbëhen nga mikroklini, plagjioklazi mesatar (30-50%), biotiti i murrmë, amfiboli (horneblendë alkalinore) dhe diopsidi. Si mineral aksesor takohet me shumicë apatiti (deri 1-2% të shkëmbit), rrallë sfeni etj. Në kontakt me ranorët arkozikë, vërehet zëvendësimi metasomatik, kryesisht për efekt të metasomatozës kaliumore. Heterogjeniteti petrografik i këtyre shkëmbinjve shprehet me praninë e llojve sienitike, leukokrate, llojeve të ndërmjetme monzonit-sienitike, deri në sienite melanokrate. Analizat kimike flasin për shkëmbinj të serisë normale deri të ngopur me alumin, me përbërje mesatare, deri diku të pangopur me SiO_2, me prirje alkalinore.

Origjina e monzonit-sieniteve supozohet magmatike intruzive e facies hipobisale-subvullkanike, nga shkrirja silikate acide-mesatare me prirje alkalinore.

Mosha e monzonit sieniteve, në bazë të dhënave të dy analizave të moshës absolute të shkëmbinjve kersantitë (llamprofirë), që trajtohen si pothuaj si njëmoshor me to rezulton 241, 512% milion vjet. Kjo moshë e përcaktuar në bazë të metodës së Kalium-Argonit i korespondon përafërsisht Triasikut të Poshtëm-të Mesëm. Janë të nevojshme përcaktime me metodën e Ar39/Ar40dhe metoda të tjera të sakta.

NJËSIA E KORITNIKUT

Ka përhapje të gjerë në rajon dhe është vazhdim direkt i Njësisë së Gjallicës të veçuar në Shqipëri, përgjatë gjithë buzës lindore të ofioliteve të Shqipërisë.

Kjo njësi kufizohet në Perëndim me formacionet oqeanike Triasike e Jurasike të brezit ofiolitik Mirditë-Gjakovë, në Jug dhe në JL me formimet Paleozoike të Njësisë së Sharrit (Kollovozit) dhe në JP me formacionet Paleozoike-Mesozoike të Njësisë së Muhurr-Çajës.

Stratigrafia

Në këtë njësi përhapen formacione të Paleozoikut, Mesozoikut dhe depozitime të Kuaternarit.

Paleozoiku (Pz)

Për këtë njësi mendojmë se formacionet rreshpore në Lindje të Zhurit (Llubiqevë, Eshkovë etj.) i përkasin Silurian-Devonianit. Janë të nevojshme studime plotësuese për të folur me siguri për përkatësinë moshore dhe tektonike.

Formacionet e Paleozoikut kanë përhapje shumë të kufizuar në lumin e Lumës, mes fshatrave Lojme dhe Bele, të Njësisë së Gjallicës. Përfaqësohen nga shiste të zeza argjilo-sericitike, që në bazë të pranisë së *krinoidit Scyphocrinites sp.* trajtohen si të moshës së Silurianit (Xhomo et al., 2005).

Permian -Triasiku i Poshtëm (P-T_1)

Përfaqësohet nga konglomerato-ranorë të kuqërremtë, që në literaturë njihen me emërtimin "Verrukano". Takohen në lumin e Lumës në Perëndim të fshatit Bele. Ato shtrihen transgresivisht mbi formacionin e rreshpeve të zeza të Silurianit dhe kanë trashësi 60m.

Në territorin e Kososvës, që ka të bëjë më Njësinë e Koritnikut, konglomerato-ranorët e kuqërremtë të facies "Verrukano" takohen në faqen e majtë të Lumbardhit të Prizrenit, me shtrirje mbi rreshpet e Silurian-Devonianit dhe nën formacionet Triasike (Elezaj, Kodra, 2008).

Mesozoiku (Mz)

Formacione të Mesozoikut kanë përhapje të gjerë në të dy anët e kufirit Kosovë-Shqipëri. Përfaqësimin më të plotë e kanë në anën e Shqipërisë, ku prerjet vijojnë mbi konglomerato-ranorët e Permian-Triasikut të Poshtëm dhe kapin të gjithë Triasikun dhe pjesërisht Jurasikun.

Në territorin e Kosovës, në Njësinë e Koritnikut zhvillohen vetëm nivele stratigrafike të Triasikut të Sipërm-Jurasikut të Poshtëm.

Triasiku i Poshtëm (T_1)

Përfaqësohet nga ranorë arkozikë, gëlqerorë oolitikë, gëlqerorë ranorikë, gëlqerorë pllakorë të zinj, gëlqerorë nyjorë të kuqërremtë etj.

Në pjesën e poshtme të tyre, direkt mbi konglomerato-ranorët shtrihen vullkanikë, të përfaqësuara nga bazalte dhe trupa të vegjël porfire kuarcorë. Mosha e këtyre formacioneve është e dhënë si e Triasikut të Poshtëm, në bazë të pranisë së mikrofacieve me *Meandrospira pusilla, Glomospirella facilis, Glamospira sinensis, Ammodiscus sp.* etj.

Triasiku i Mesëm (T_2)

Prerje të Triasikut të Mesëm takohen në të dy anët e kufirit si në Vanas, Bele, Pakish, Krstaq, Rapçe, Breznë, Stanet e Vërmicës, etj. Prerjet e Anizianit janë tepër të ngjajshme dhe të korrelueshme, ndërsa ato të Ladinianit ndryshojnë. Aniziani përfaqësohet nga gëlqerorë dolomitikë të kuqerremtë deri verdhacakë. Trashësia 100-120m. Pinari Sh. (1970) ka përcaktuar brakiopodët: *Tetractinella trigonella, Spiriferina fragilis, Mentzelia mentzeli, Coenothypris vulgaris.* Gjithashtu janë

përcaktuar krinoidet: Enchrinus liliformis, Monocrinus deeck*ei, Dadacrinus cf. gracilis,* etj., që përcaktojnë Anizianin e Poshtëm dhe të Mesëm. Gëlqerorët dolomitikë mbajnë në tavan gëlqerorë biomikritikë, nyjorë, të kuqërremtë, të pasur me amonite, brakiopodë, bivalvorë dhe krinoidë. Ndër amonitet shënojmë: *Norites gondola, Bulogites gosaviensis, Ptychites oppeli, Paraceratites cf. trinodosus, Flexoptychites flexuosis, Monophyllites sphaerophyllum*, etj, që, përcaktojnë Anizianin e Sipërm. Prerjet e Ladinianit në Grykën e Vanave përfaqësohen nga rreshpe argjilo - alevrolitike, silicorë radiolaritikë dhe mbi to gëlqerorë biomikritikë pllakorë, me thjerrëza e shtresa silicorësh në të cilët është gjetur amoniti *Aplococeras avianus*, që daton Ladinianin. Në pjesën e sipërme të gëlqerorëve pllakorë takohen edhe tufe të gjelbra të përbërjes mesataro-acide. Në të gjithë anën Kosovare të kufirit nuk takohen prerje të Ladinianit, të ngjashme me ato të Grykës së Vanave. Evidentohet një vijimësi e gëlqerorëve platformikë të mermerizuar dhe pak të dolomitizuar mbi nivelet e gëlqerorëve të kuq nyjorë të Anizianit të Sipërm. Situata të ngjashme takohen edhe në rajone qendrore e jugore të Njësisë së Gjallicës në Shqipëri në Borovë, Lin, etj.

Triasi i Sipërm-Jura e Poshtme (T_3 -J_1)

Triasikut të Sipërm-Jurasikut të Poshtëm i përket formacioni i gëlqerorëve platformikë në të dy anët e kufirit Kosovë-Shqipëri. Vërehet se shkalla e metamorfizmit nga JP drejt VL vjen duke u rritur, gjë që shprehet me praninë e gëlqerorëve të mirëfilltë në pjesën perëndimore dhe mermerizimin e gëlqerorëve në të gjithë pjesën verilindore të malit të Koritnikut.

Në pjesën perëndimore formacioni i Triasikut të Sipërm-Jurasikut të Poshtëm përfaqësohet nga një facie gëlqerorësh neritikë, algorë, shtresëtrashë deri masivë, kryesisht me ngjyrë gri në të bardhë. Gëlqerorët janë biomikritikë, më rrallë biosparitikë, pak të dolomitizuar. Trashësia e tyre është 1200-1500 m, por për shkak të shkëputjeve tektonike ato paraqiten më të trashë. Argumentimi moshor i Triasikut të Sipërm është mjaft i pasur (Xhomo, etj., 2002). Janë përcaktuar foraminiferët: *Involutina gr. sinuosa, I. gaschei, I. communis, Trochammina alpina, T. jaunensis, Ophthalmidium fusiforme, O. chalinychiangense, Glomospirella friedli, Turrispirilina minima, Agathamina austroalpina, Endothyra kupperi, Galeonella cf. pantica, Triasina hantkeni, Turritellella sp., Theosmilia clatrata, Th. Finestrata, etj. Alget: Clypeina besici, Codiaceae, Thaumatoporella parvovesiculifera.*

Incertae sedis: Baccanella floriformis, Globochaeta alpina, etj.

Nga makrofauna takohen: *Bivalvoret: Megalodus sp., M. triqueter, M. Damesi, Gastropodet: Omphaloptycha sp., Trochynerita sp., Naticiella sp., etj.* Koralet: *Montivaltia norica, Phylloceonia decustata, Coccoplyllum sturi,* etj.

Nivelet kalimtare nga Triasiku i Sipërm në Jurasik të Poshtëm, përgjithësisht pranohen ato me rritje të dukshme të pranisë së algës *Thaumatoporella parvovericulifera.* Në anën Kosovare të kufirit formacioni gëlqeror i mermerizuar ofron të dhëna të kufizuara biostratigrafike për Triasikun e Sipërm-Jurasikun e Poshtëm. Karaviq et al. (1982) për pjesën veriore dhe verilindore të malit të Kortnikut (Dobruzhë, Zhurr-Çesma e Hajdutit) evidenton konodontet *Hindeodella petrae-viridis, Gondolella navicula, Prioniodella pectenifortis, Ozarcodina tortilis, Hindeodella multihamata, Roundia magnidentata, Lonhodina latidentata* etj. Format e më sipërme i përkasin niveleve të sipërme të Anizianit deri në Triasikun e Sipërm. Në gëlqerorët që vijojnë në Lindje të rajonit tonë janë takuar makrofaunë megalodontesh si *Megalodus boschi, Megalodus sp.* etj. që dokumentojnë katin Norian të Triasikut të Sipërm. Shënojmë se kufiri i sipërm i gëlqerorëve të Triasikut të Mesëm me ato të Triasikut të Sipërm-Jurasikut të Poshtëm është i supozuar.

Jurasiku i Sipërm (J_3)

Formacionet e Juraskut me shtrirje mbi gëlqerorët e mermerizuar të Triasikut të Sipërm-Jurasikut të Poshtëm nuk kanë përhapje në Njësinë e Koritnikut. Edhe në pjesën Shqiptare formacionet e Jurasikut të Sipërm kanë përhapje të kufizuar. Ato përfaqësohen nga një fragment i vogël tektonik i rreshpeve me blloqe në Qafën e Sbinecit dhe tufobrekçe ofolitike

pranë fshatit Morinë. Marrëdhëniet e tufobrekçeve me gëlqerorët e Triasikut të Sipërm-Jurasikut të Poshtëm nuk vrojtohen, për shkak të mbulesës Kuaternare, por ne i konsiderojmë që formimet terrigjene të Jurasikut të Sipërm shtrihen mbi gëlqerorë platformikë. Sikundër është e njohur në vazhdimin jugor të Njësisë së Gjallicës gëlqerorë të kuq nyjorë dhe silicorë radiolaritikë të Jurasikut dhe brekçe e tufobrekçe të Jurasikut të Sipërm takohen me shtrirje normale, stratigrafike mbi gëlqerorët platformikë të Triasikut të Sipërm-Jurasikut të Poshtëm (Bicaj, Domaj, Resk, Fushë Lurë, etj.) Gëlqerorë të kuq nyjorë të Jurasikut të Poshtëm-të Mesëm në tavan të gëlqerorëve platformikë janë kapur edhe në JP të Bardhocit, në thellësi me shpime të kryera për kërkimin e mineralizimeve të bakrit në formacionin vullkano-sedimentar të rajonit Gjegjan-Bardhoc.

Tektonika

Njësia e Koritnikut është mjaft e prekur veçanërisht nga tektonika shkëputëse. Sikundër kemi cekur më lart, në pjesën JP të saj kontakton tektonikisht me Njësinë e Muhurr-Çajës. Nuk evidentohen marrëdhënie tektonike mbulesore mes tyre. Në pjesën J dhe JL Njësia e Koritnikut i nënshtrohet tektonikisht Njësisë së Sharrit. Kjo e fundit braniset qartësisht mbi Njësinë e Koritnikut. Marrëdhëniet e Njësisë së Koritnikut më formacionet oqeanike në cepin VP të planshetit, janë tepër të ndërlikuara. Në plan regjional dhe paleotektonik, formacionet oqeanike të brezit ofiolitik Mirditë-Gjakovë janë mbivendosur mbi formacionet pelagjike e pjesërisht platformike të buzës kontinentale. Tektonika pas Kretake e ka ndërlikuar edhe më shumë situatën tektonike. Vetë Njësia e Koritnikut paraqet pamje të ndryshme në pjesën JP dhe VL. Në JP, përgjatë Grykës së Vanave kemi një strukturë monoklinale të formacioneve Triasike të Njësisë së Koritnikut. Përgjithësisht kemi shtrirje JPP-VLL dhe rënie V-VP të karbonateve dhe formacioneve terrigjene, etj. poshtë tyre. Këndi i rënies së gëlqerorëve rritet së tepërmi deri në afro vertikale.

Në pjesën VL të Njësisë, që i përgjigjet tërësisht territorit Kosovar evidentohet një strukturë antiklinale, asimetrike, me krah të zgjatur drejt VP dhe krah të ngushtë drejt J-JL. E gjithë Njësia ndërtohet nga shkëputje tektonike me shtrirje VL-JP dhe rënie JL, që përgjithësisht ka natyrë të shkëputjes normale.

Si rezultat duket sikur kemi trashësi shumë të mëdha të gëlqerorëve, ndërkohë që trashësia e tyre është më e vogël. Shkëputjet VL janë më të vjetra se ato me shtrirje VP.

Magmatizmi

Njësia e Koritnikut është shumë e varfër në shkëmbinj vullkanikë. Vetëm shfaqje të kufizuara të vullkaniteve bazikë në trajtë rrymash llavore, shoqëruar me trupa tepër të vegjël riolitesh evidentohen në Vanat (në territorin Shqiptar). Përfaqësohen nga bazalte e porfirite bazaltike, herë herë me titanoaugit dhe olivinë. Këto vullkanite shtrihen mbi konglomeratet e kuqërremtë të Permian-Triasikut të Poshtëm dhe mbulohen nga ranorë e gëlqerorë ranorikë të Triasikut të Poshtëm.

Disa Probleme të Diskutueshme në Korrelimet Gjeologjike të Territoreve Kufitare Kosovë-Shqipëri

Për Njësinë e Sharrit

- Mundësia e veçimit të formacioneve të Silurian-Devonianit në pjesën Veriperëndimore të planshetit.
- Studime të thelluara dhe hulumtime, për mundësinë e konkretizimit të vendburimeve radioaktive në dhe përreth masivëve të monzoniteve etj. që janë me përhapje të gjerë në rajonin në mes të Dragashit dhe Brodit dhe në Lindje të Radeshës etj.
- Evidentimi më i saktë i rrafshit të branisjes së formacioneve të Njësisë së Sharrit mbi ato të Koritnikut në Lindje të Llapushnikut.
- Kryerja e studimeve tematike për sqarimin e natyrës së daljeve karbonatike Triasike në Njësinë e Sharrit, në se ato përfaqësojnë prerje normale mbi rreshpet e Ordovikian - Silurianit apo janë dritare tektonike të Njësisë së Koritnikut.

Për Njësinë e Abdavit

- Të saktësohet mosha e formacioneve karbonatike - rreshpore e radiolaritike

të Njësisë së Abdavit në se ato i përkasin Devonianit apo Triasikut (mos ndoshta i kemi të dy moshat?).

Për Njësinë e Koritnikut

- Të studiohet përkatësia tektonike e formacioneve karbonatike në pjesën verilindore të planshetit.
- Me studime dhe rilevime të detajuara të saktësohen marëdhëniet e formacioneve karbonatike Triasike të Njësisë së Koritnikut me formacionet oqeanike (bazalt-radiolaritet, melanzhi "blloqe në matriks") të Njësisë së Vërmicës.

Për Njësinë e Vërmicës

- Me rilevime të detajuara të veçohet formacioni vullkano-sedimentar bazalt-radiolaritik (β T2- J1) nga formacioni i melanzhit "blloqe në matriks" (J2?-3).
- Të bëhen hulumtime komplekse gjeologo-gjeokimike-gjeofizike të detajuara, në formacionin vullkano-sedimentar, bazalt-radiolarit të rajonit Vërmicë-Shkozë, tepër perspektiv për mineralizimet masive sulfide të bakrit.

Litratura

Anonim (1974). Geolloshka - Tektonska karta Kosovo. Sc. 1:100 000.

Arsovski M. (1997). Tektonika na Makedonia, Stip, 1997.

Aubouin J., Blanchet R., Cadet J P, Celet P, Charvet J, Chorowicz J, Cousin M, Rampnoux J P. (1970). Essai sur la géologie des Dinarides. Bull. Soc. Géol. Fr., 12. 1060 - 1095.

Barth A., Legler C., Hoffman B., Kühne H., Maliqi G., Peci N. (2006). Map of Mineral of Kosovo. Sc. 1:200 000. KPM.

- Our observations argue for a variation along the Shpat-Kuterman massif (MORB) with an increase in the influence of SSZ (Koller et al., 2004) as well as in the Shebenik-Pogradec massif with SSZ features, MORB environment features are also observed (confirmed by Bebien, Shallo, Manika, 1998). These data confirm the idea that there is a closer geological, geochemical and petrological connection between the two generations of ophiolites of the Mirdita area that remain simultaneously and with marked differences.
- It is given by Bebien, Manika, Shallo et al. (1998) a three-stage evolution model of the Shebenik-Pogradec massif ophiolitic complex (eastern belt of ophiolites) including:
  1. *Formation of the harzburgite mantle.*
  2. *Formation of ultramafic-mafia cumulative sequence accompanied by Ti-rich magmas.*
  3. *Formation of basalts with low Ti and boninites.*
- These stages correspond best with the formation of the Shpat-Kuterman ophiolitic complex in the western belt of the ophiolites.
- A model for the close relationship of MORB and SSZ basalts with ultramafic and mafia cumulative rocks can be based on the assumption of the beginning of an intraoceanic subduction zone which "disturbs" an asthenospheric "mantle" under a mid-oceanic ridge. Such a situation could generate a rare configuration of a close spatial and temporal relationship between an asthenospheric mantle that still produces MORB-type fusion and a mantle sector influenced by a high-water input subduction zone which generates magma with You are low and very low (boninitic). (Koller, 2004).

Table 1

Sam.	Unit	SiO2	TiO2	Al2O3	Fe2O3	MnO	MgO	CaO	Na2O	K2O	P2O5	H2O	CO2	Sum
A/286	Shpati (Dunite)	35,179	0,027	1,406	11,288	0,144	40,886	0,532	0,000	0,018	0,009	9,165	0,035	100,051
A/287	Shpati (Harzburgite)	43,833	0,030	0,717	8,998	0,129	45,197	0,786	0,000	0,000	0,010	0,245	0,054	100,877
A/418	Shpati (Plagioclase-Lherzolite)	39,930	0,027	1,346	7,773	0,115	37,902	0,885	0,000	0,009	0,009			100,029
A/430	Shpati (Plagioclase-Lherzolite)	46,255	0,378	5,697	5,978	0,116	23,108	14,340	0,862	0,010	0,010			100,341
A/431	Shpati (Gabbro)	34,553	3,117	6,367	20,394	0,228	11,309	18,702	0,171	0,010	0,029			99,910
A/338	Shebenik (Dunite)	34,098	0,017	0,042	7,450	0,102	42,286	0,051	0,000	0,000	0,008			99,428
A/339	Shebenik (Harzburgite)	38,688	0,018	0,595	7,787	0,107	40,206	0,648	0,000	0,000	0,009			99,749
A/340	Shebenik (Harzburgite)	36,877	0,017	0,368	7,346	0,103	39,648	0,385	0,000	0,000	0,009			99,646
A/380	Shebenik (Harzburgite)	39,449	0,020	0,250	8,660	0,110	41,589	0,360	0,070	0,010	0,010			99,242
A/381	Shebenik (Dunite)	35,508	0,020	0,120	7,150	0,100	43,738	0,190	0,600	0,020	0,010			99,939
A/751	Shebenik (Dunite)	34,208	0,039	0,185	6,597	0,093	42,448	0,076	0,003	0,008	0,019			100,104
A/752	Shebenik (Harzburgite)	38,339	0,041	0,353	8,154	0,115	40,093	0,406	0,011	0,011	0,019			99,984

Literature

Onuzi K., Koller F. (2021). Komplekse Ofiolitike të Shqipërisë Juglindore, UPT-IGJ-Universiteti i Vienës.

Junge M., Kolb A. Ch., Wittenberg A., Sievers H., Gega D., Onuzi K. (2020). Mineralogical characterization of podiform chromitite deposit in the Mirdita Ophiolite, Albania. Albanien, Chromite, ZDGG.

Ntaflos Th., Onuzi K. , Hauzenberger Ch., Hugh A., Rice N., Prossegger P. (2016). The Mirdita Eastern Ophiolite, Albania: petrological evidence for MORB Mantle in the Tropoje peridotite massif. EGU General Assembly 2016.

Massonne H. J., Koller F., Onuzi K. (2016). P-T evolution of slivers of garnet-bearing micaschist in the sole of the Western Vardar Ophiolite Unit at Brezovica, Kosovo. EGU General Assembly 2016.

Hoeck V., Koller F., Onuzi K., Ionescu C. (2014). The Southern Albanian ophiolites. CBGA 2014,Tirana.

Havancsák I., Koller F., Kodolányi J., Szabó C., Hoeck V. & Onuzi K. (2011). Chromite-hosted Silicate Melt Inclusions from Basalts in the Stravaj Complex, Southern Mirdita Ophiolite Belt. (Albania) Turkish Journal of Earth Sciences (Turkish J. Earth Sci.),Vol. 21, 2012, pp. 79–96. Copyrightc TUBİTAK doi: 10.3906/yer-1010-40 First published online 23 January 2011.

Koller F. ,Hoeck V., ,Hohenegger J., Briguglio A., Ionescu C., Onuzi K., Gega D. (2008). Late Jurassic clastic sediments on top of the Luniku ophiolite sequence (Ophiolites and the Palaeogeographic and Tectonic Reconstruction of the Alpine-Carpathian-Dinaric OrogenicBelt). Salzburg 2008.

Onuzi K., Koller F., Goriçan S., Gega D. et al. (2008). Gjeologjia e Rajonit Librazhd-Korçë. Instituti i Gjeoshkencave, Tiranë.

Dilek Y., Furnes H. & Shallo M. (2008). Geochemistry of the Jurassic Mirdita Ophiolite (Albania) and the MORB to SSZ evolution of a marginal basin oceanic crust. Lithos, 100, 174-209.

Onuzi K, Gega D. (2007). Korrelime gjeologjike në shk.1:50 000 si dhe teksti shpjegues i Planshetit 53 Skroska. (Fondi I.K.GJ.).

Koller F. (2006). Die südalbanischen Ophiolite MORB vs. Supra-Subduction Environment. Bochum 2006.

Koller F., Hoeck V., Meisel T., Onuzi K., Ionescu C., Gega D. (2006). Cumulates and gabbrosin south Albanian ophiolites (Tectonic Development of the Eastern Mediterranean Region, Geological Society 2006) ISBN. London.

Koller F., Hoeck V., Meisel T., Onuzi K., Ionescu C., Gega D. (2006). Cumulates and gabros in south Albanian ophiolites (Geophysical ResearchVol.8). EGU.

Koller F., Hoeck V., Meisel T., Ionescu C., Onuzi K. & Gega D. (2006). Cumulates and gabros in southern Albanian ophiolites: their bearing on regjional tectonic setting. In: Robertson, A. H. F. & Mountrakis, D. (eds.) Tectonic Development of the Eastern Mediterranean Region, Geological Society London Special Publication 260, 267-299.

Bébien J., Shallo M., Manika K. & Gega D. (1998). The Shebeniku massif (Albania): a link between MOR- and SSZ- type ophiolites?. Ofioliti 23, 7-15.

Manika K., Shallo M., Gega D. (1998). Gjeokimia e vullkaniteve të formacionit vullkanogjeno-sedimentar të sektorit Qarrishtë – Skënderbej. Bul. Shk. Gjeol., 1, 33 –42.

Manika K. (1994). Pétrologie du massif ophiolitique de Shebeniku (Albanie). Thése, Univ. D'Orsay .

Shallo M., Kote Dh., Vranai A., Premti I. (1985). Magmatizmi ofiolitik i RSH.

Zhdanov, Cili P. (1960). Ultrabazikët e Shqipërisë Juglindore.

KORRELIME GJEOLOGJIKE TË ZONËS KUFITARE SHQIPËRI-KOSOVË (PLANSHETI K-34-78-A, SHISHTAVECI, Shkalla 1: 50 000)

Vesel Hoxha*, Alaudin Kodra*, Sabri Avdullahi **

Abstrakt

Rajoni ndërtohet kryesisht nga formacione Paleozoike të Ordovikian-Silurianit. Me përhapje më të vogël takohen formacionet e Silurian-Devonianit, Devonianit?, Permo-Triasikut të Poshtëm, Triasikut-Jurasikut dhe depozitimet e Kuaternarit kryesisht ato morenore. Në territorin e Kosovës për herë të parë veçohen njësitë tektonike të Sharrit dhe Abdavit që i korrespondojnë përkatësisht njësive tektonike të Kollovozit dhe Malësisë së Korabit në territorin e Shqipërisë. Në pjesën perëndimore të planshetit takohet Njësia tektonike e Muhurr-Çajës. Në Njësinë e Sharrit, në dallim nga hartat e botuara më parë, formacionet e datuara si të Permian-Triasikut apo të Devonianit, apo si të Paleozoikut të Sipërm, argumentohen nga ana jonë si të Ordovikian-Silurianit dhe korrelohen shumë mirë me formacionet njëmoshore në territorin e Shqipërisë. Njësia tektonike e Sharrit për herë të parë trajtohet e branisur tektonikisht mbi njësitë kufitare me të. Për Njësinë e Abdavit, në dallim nga hartat e botuara më parë, formacionet e datuara si të Triasikut të Poshtëm të Mesëm dhe, të Paleozoikut të Sipërm, me të dhëna të zbehta faunistike interpretohen si të moshës së Devonianit?. Magmatizmi ignimbritik-riolitik, monzonite-sienit, grano-sienit dhe seria llamprofire etj, identifikohen me saktë me analizë të plotë kimike të komponenteve madhore, elementeve gjurmë dhe toka të rralla. Në hartën e paraqitur realizohet një korrelacion i mirë i formacioneve kufitare në të dy anët e kufirit Kosovë-Shqipëri. Në të ardhmen duhet të kryhen punime të detajuara rilevimi në shkallë 1:25 000, të cilat do të sqarojnë gjeologjinë tepër të komplikuar të rajonit dhe perspektivën mineralmbajtëse të tij, kryesisht për mineralet e hekurit, manganit, radioaktivët dhe mineralet jo metalorë.

Fjalë kyç: *Sharri, Abdavi, paleozoi, magmatizëm, tektonikë, konodont.*

Qëllimi

Qëllimi i studimit ishte realizimi i korrelimit të formacioneve gjeologjike të zonave kufitare në fjalë, të sqaronte problematikën gjeologjike që reflektohej në harta të shkallëve të ndryshme të përpiluara për rajonet në të dy anët e kufirit si dhe, të ndërtonim një rajonizim të ri tektonik, bazuar në rezultatet korreluese.

Hyrje

Studimet më të hershme në rajon (Fig. 1) dhe më gjerë i përkasin A. Boue (1836-1864) dhe Visquenel (1844). K. Oestereich (1902) i trajton si të Paleozoikut rreshpet dhe mermerët e rajonit të Malit të Thatë (Suva Gora). Nikoliq (1912) dhe Smilaniq et al. (1929) japin të dhëna gjeologjike për rajonin e veçanërisht për depozitimet glaciale të maleve të Sharrit dhe Korabit.

Kossmat (1924), Nopsca (1929), Kober, Gripp (1922), Tukan (1934), kontribuojnë në rritjen e njohjes së rajoneve të përhapjes së formacioneve Paleozoike. Heritsch (1934) në Qafën e Kadisë etj., në lindje të rajonit tonë përshkruan fragmente koralesh, ortocerash etj., me moshë të Silurian-Devonianit. Petkovski, Sikoshek (1982) japin në mënyrë të detajuar studimet e kryera deri në vitin 1975 në rajonin e planshetit K-34-78 (Gostivar) dhe rajonet përreth. Në hartën e vitit 1975 të Kosovës në shkallën 1:100 000 përpiluar nga specialistë Kroatë, në rajonin e planshetit K-34-77 jepen formacione rreshpore dhe mermerë të Paleozoikut, filite të Paleozoikut etj. Në rrjedhën e sipërme të Përroit të Brodit vizatohen formacione të Kretakut më të sipërm (K32) por që nga verifikimi jonë nuk i përgjigjen realitetit pasi janë formacione të Devonianit?. Është me shumë interes të theksohet që në këtë hartë veçohen shumë mirë formacionet e njësisë së Sharrit, të veçuar nga ana jonë nga formacionet e njësisë së Abdavit, të veçuar po nga ana jonë,

*UPT, IGJEUM, Tiranë; **Un. Isa Boletini, Fakulteti i Gjeoshkencave, Mitrovicë
e-mail: vesel.hoxha@gmail.com; veselhoxha52@yahoo.com

por që interpretohen prej tyre pa marrëdhënie mbulesore. Autorët paraqesin mjaft mirë formacionet magmatike acid-alkalinore të rajonit. Petkovski, Sikoshek (1982) në hartën 1:1 00 000 të planshetit K-34-77 (Gostivar) dhe tekstit shpjegues të saj, gjithë formacionet e njësisë të veçuar nga ana jonë si Njësia e Abdavit, i trajtojnë si të Triasikut. Formacionet e Njësisë së Sharrit i japin si të moshës Devonit dhe Permo-Triasikut. Sikundër do të shtjellojmë në tekst dhe paraqesim në hartë këto janë formacione kryesisht të Ordovikian-Silurianit. Është me interes të theksohet që autorët, formacionet magmatike acide-alkalinore të rajonit (diorite, granodiorite, grano-sienite etj.) i konsiderojnë të moshës së Jurasikut gjë që përputhet edhe me të dhënat e moshës absolute të granodioriteve të Staneve të Preshit në Shqipëri. Knobloch, Legler (2006) të gjithë formacionet rreshpore, kuarcitike dhe karbonatike të planshetit K-34-78-A i trajtojnë si të Paleozoikut të Sipërm duke eliminuar tërësisht Triasikun dhe duke mos trajtuar fare formacionet e Paleozoikut të Poshtëm. Në hartën gjeologjike në shkallë 1: 50 000 të autorëve gjerman (Marrë nga KPMM), trajtimet bëhen në përputhje me hartën e Petkovski, Sikoshek (1982).

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME GJEOLOGJIKE

Rajoni i planshetit K-34-78-A, bën pjesë në Zonën Tektonike të Korabit, si pjesë e Mikroblokut Korab-Pelagonian (Fig. 1, 2, 3, 4 dhe 5).

Në rajon veçohen:

Njësia tektonike e Sharrit, me ekuivalenten e saj në Shqipëri, Njësinë e Kollovozit;

-Njësia tektonike e Abdavit me ekuivalenten e saj në Shqipëri, Njësinë e Malësisë së Korabit;

-Njësia tektonike e Muhur-Çajës. Përhapet vetëm në territorin e Shqipërisë.

Nuk evidentohen zhveshje të Njesisë së Muhur-Çajës në territorin e Kosovës.

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR NJËSITË OSE NËNZONAT E ZONËS SË KORABIT.

NËNZONA E KOLLOVOZIT

Kjo nënzonë ndërtohet kryesisht nga depozitimet Ordovikiane dhe më pak nga ato Siluriano-Devoniane. Prerja Ordovikiane, në pjesën e poshtme, përfaqësohet me ranorë, rreshpe, alevrolite, kuarcite e vullkanite acide dhe mbaron me ranorë, rreshpe alevrolitike, shtresa e horizonte kuarcitesh mbi të cilat vendoset trupi xeheror i hekurit oksido-silikat. Mbi trupin xeheror, vendosen rreshpet e zeza Siluriane me shtresa të gëlqerorëve me Scyphocrinites sp. konodonte të Silurianit të Sipërm dhe Devonianit të Poshtëm. Në nënzonën e Kollovozit, depozitimet Triasike kanë përhapje të kufizuar në Malin e Sorokolit dhe shtrihen transgresivisht mbi depozitimet Siluriano-Devoniane. Magmatizmi, përveç vullkaniteve acide, shprehet dhe me shtresa të rralla të diabazeve, gabrodiabazeve e mineteve. Nënzona e Kollovozit përbën një strukturë monoklinale me rënie lindore etj. Gabrodiabazet takohen kryesisht në trajtën e trupave ndërshtresorë të vegjël me vendosje pajtuese me shkëmbinjtë anësorë të facies se gabro-diabazeve albitike. Ato janë takuar deri tani vetëm në depozitimet me moshë Ordovkiane. Kollovozi është i branisur mbi Muhurr-Çajën. Balli i mbihypjes ndiqet nga Lugina e Çajës në Rrafshin e Korabit, ku kjo malësi mbihyp mbi atë të Malësisë së Korabit.

NËNZONA E MUHURR-ÇAJËS

Shtrihet në trajtën e një brezi, në perëndim të Malësisë së Kollovozit. Kjo njësi ka përfaqësuar një hulli, duke filluar nga Siluriani. Midis depozitimeve Paleozoike përhapjen me të madhe e kanë rreshpet e zeza argjilore e argjilo-silicore me graptolitet e Landoverianit, Uenlokianit e Landlovianit (Xhomo, 1985; 1987; Qirici, 1982). Studimi i graptoliteve kohët e fundit ka çuar në veçimin e mjaft biozonave (Pashko, 1987; 1988; 1989). Mbi depozitimet Siluriane, vendosen ato Devoniane e, në pjesën e poshtme ato Lohkoviane në Muhurr dhe përmbajnë graptolite. Me lart, ato pasurohen me shtresa gëlqerorësh e kalojnë në formacionin e rreshpe-

ve me gëlqerorë e tentakulite të Korabit (Pragian-Zlihovian). Në këtë njësi, takohet horizonti i gëlqerorëve biomikritikë me Scyphocrinites sp. që i përket Silurianit të Sipërm dhe Devonianit të Poshtëm. Magmatizmi shprehet me vullkanitet bazike, shpesh me anësim alkalinor, me tufe e tufite, monconite e minete. Nënzona e Muhurrit ka përfaqësuar një hulli me kushte sedimentimi të rralla dhe më të qeta në krahasim me Kollovozin. Kjo veçori është përsëritur, me sa duket, edhe pas Permian-Triasikut të Poshtëm e sidomos, gjatë Ladinianit e Triasikut të Sipërm.

Fig. 1 *Harta skematike me pozicionin e planshetit K-34-78-A (Shistaveci), në zonën Kufitare Shqipëri-Kosovë-Maqedoni e Veriut*



Fig. 2 *Skema tektonike e rajonit të planshetit K-34-78-A (Shishtaveci), pjesë e bllokut kontinental Korab-Pelagonian*

NËNZONA E MALËSISË SË KORABIT

Pjesët më të thella të prerjes përfaqësohen nga rreshpe argjilore alevrolitike që në pjesën e poshtme, janë Siluriane. Më lart, prerja shndërrohet në rreshpore, me shtresa gëlqerorësh me tentakulite, Crinoidë, Cefalopodë etj. që dora dorës kalojnë në gëlqerorët e Malit të Korabit të Devonianit të Poshtëm të Mesëm. Në sektorët e Bjeshkëve të Shehut, Staneve të Preshit dhe të Zonjave, në pjesën e poshtme, mbizotërojnë depozitimet terrigjene ranoro-konglomeratike me rreshpe e karbonate e mandej rreshpe argjilorogëlqerore e shkëmbinj vullkanikë. Konodontët e përcaktuara dëshmojnë se këto depozitime i përkasin pothuajse të gjithë Triasikut.

Mosha e depozitimeve të Bjeshkës së Zonjave dhe asaj të Shehut, në territorin Shqiptar, kryesisht ajo me natyrë rreshpore, nuk përkon me moshën e dhënë në Hartën Gjeologjike të Maqedonisë së Veriut në shkallë 1:200 000, të vitit 1975. Kjo ngelet për tu sqaruar në të ardhmen. Në pjesën jugore të Nënzonës së Malësisë së Korabit, në V e VL të Peshkopisë, takohet mbulesa e Gramës, e ndërtuar nga formacioni vullkanogjeno-sedimentarë që, në kreun e tij, përmban gëlqerorë pllakorë me silicorë. Këto depozitime pranohen të Triasikut të Poshtëm por, për moshën e tyre, duhet të kryhen studime të mëtejshme. Granosienitet përfaqësohen nga dalje të zgjatura në pajtueshmëri me shkëmbinjtë anësorë, duke u lokalizuar brenda formacionit të gëlqerorëve dhe rreshpeve me vullkanite të Staneve të Preshit (T1-2).

Marrëdhëniet me shkëmbinjtë anësorë janë intruzive. Granosienitet mund të mendohen si burim i disa mineralizimeve të As, Pb etj. Shkëmbinjtë vullkanikë shfaqen në një diapazon të madh moshor me përbërje bazike deri mesatare, e rrallë mesataro-acide.

Përveç vullkaniteve bazike, në depozitimet Devoniane dhe ato Triasike bazike e



Fig. 3 Profili gjeologjik A-A, i ndërtuar në zonën kufitare Shqipëri-Kosovë, sipas drejtimit Veriperëndim (VP)-Juglindje (JL).

mesatare acide që përmenden në nënzonën në fjalë, në afësi të Staneve të Preshit dhe Fushës së Panaireve, janë takuar dhe trupa shkëmbinjsh ultrabazikë me natyrë të veçantë.

Kjo nënzonë, në sektorët veriore, është mbihypur nga depozitimet e nënzonave të Kollovozit dhe Muhurrit dhe, së bashku me këto, mbihyp e mbulon diapiret e evaporiteve të Peshkopisë dhe shkëmbinjtë flishoidale të Titonian-Kretakut të Sipërm e Paleogjenit, që rrethojnë kupolat e evaporiteve.

Në përshkrimin e stratigrafisë, tektonikës dhe magmatizmit për çdo njësi do të japim të dhënat për territorin e Kosovës dhe korrelacionet përkatëse me formacionet dhe strukturat njëmoshore të territorit shqiptar.

NJËSIA E SHARRIT

Njësia e Sharrit ka përhapje të gjerë në pjesën perëndimore të territorit të Kosovës (në kufijtë e këtij plansheti) dhe zë pothuajse tërësisht pjesën e territorit të Shqipërisë. Në territorin e Kosovës përhapet nga Brodi, Zli Potoku e Krusheva në veri, deri në Kësulën e Priftit dhe rrjedhën e sipërme të Lumit të Radikës në jug. Në territorin e Shqipërisë përfshin fshatrat e Shishtavecit, Novosejës, Shtrezit, Topojanit dhe Brekijes në veri, e deri në Malësinë e Sorokolit në Jug. Në hartat gjeologjike ekzistuese ka mospërputhje të dukshme, veçanërisht në datimin moshor të formacioneve.

STRATIGRAFIA

Në njësinë tektonike të Sharrit (Kollovozit) veçohen formacione të Paleozoikut, Mesozoikut dhe depozitime të Kuaternarit.

Paleozoiku

Ordovikian-Siluriani (O-S)

Formacionet e Ordovikian-Silurianit kanë përhapje të gjerë në rajonin e planshetës K-34-78-A dhe zënë afro 70 % të tij. Ato janë vazhdim direkt jugor i formacioneve njëmoshore të Njësisë së Sharrit të planshetës K-34-66-C.

Përfaqësuesit kryesorë të formacioneve të Ordovikian-Silurianit janë kuarcitet dhe ranorët kuarcorë, rreshpet kuarc-serici-



***Fig. 4** Harta gjeologjike e zonës kufitare Shqipëri-Kosovë në shkallë 1:50 000, Plansheti K-34-78-A (Shishtaveci).*



***Fig. 5** Shpjeguesi i hartës "Korrelime gjeologjike të zonës kufitare Shqipëri -Kosovë", shkalla 1:50 000, Plansheti K-34-78-A (Shishtaveci)*

tike, klorit sericitike dhe filitet. Veçanërisht këto të fundit kanë përhapje të gjerë në rajonin tonë dhe ndërtojnë pjesën e poshtme të prerjes. Ato përfaqësohen nga rreshpe kloritike, klorito-sericitike, klorito-epidotike dhe klorito-aktinolitike. Karakteristike është prania mes tyre e ndërshtresave kuarcitike dhe ranorëve kuarcor të cilët shtohen veçanërisht në nivelet më të poshtme të prerjes së Ordovikian-Silurianit si p.sh. në Malin e Kallabakut, në afërsi të fshatit Brod (pranë ballit të branisjes së Njësisë së Sharrit mbi Njësinë e Abdavit etj.). Nivele të poshtme stratigrafike të Ordovikian-Silurianit takohen edhe më në Jug të Përroit të Thatë (Suva Reka) dhe veçanërisht në Kullën e Zyberit, në lindje drejt Popova Shapkës dhe kuotës 2183 m, poshtë Gurit të Zi (Crni Kamen).

Në territorin e Shqipërisë nivele të poshtme të Ordivokian-Silurianit takohen veçanërisht në pjesën veri-perëndimore të planshetit pranë ballit të branisjes së Njësisë së Kollovazit (Sharrit) mbi Njësinë e Muhurr Çajës dhe mes Buzëmadhes e Malit të Kallabakut. Mbi kuarcitet, ranorët kuarcore dhe rreshpet klorit-sericitike në këto rajone takohen edhe ignimbrite etj., që ndiqen pothuajse pa ndërprerje nga Kollovozi, Shtresi e Turaj deri në Malin e Kallabakut në kufirin Kosovë-Shqipëri. Ato takohen edhe më në Jug, deri në Kepin e Zanit. Dalje të ignimbriteve takohen edhe nga Shtrezi drejt Shishtavecit. Duhet theksuar që në territorin e Kosovës, në Jug të Glloboçicës edhe drejt Krushevës, përveç ignimbriteve të mirëfillta takohen me shumicë edhe facie subvullkanike riolitike (të quajtura me parë porfire kuarcore).

Në të dy anët e kufirit, mbi nivelet e poshtme të Ordovik-Silurianit të trajtuara më sipër takohen formacione rreshpore kuarc-sericitike të cilat zhvillohen gjerësisht në territoret mes Brodit dhe Zli Potokut, në J-P të Restelicës etj. Përfaqësohen nga kuarci e sericiti dhe me pak kloriti, magnetiti, hematiti, apatiti etj. Mbi to takohen filitoide të cilat ndërtojnë gjërësisht rajonet mes Krushevës dhe rajoneve jugore deri në rrjedhjen e sipërme të Lumit të Çajës etj. Ato takohen edhe në verilindje të Buzëmadhes etj. Përfaqësohen nga argjilo-filite, rreshpe kuarc-sericitike, alevrolite, ranorë kuarcorë, rreshpe kuarc-sericit-grafitike, klorit-siricitike etj. Kanë ngjyra të gjelbërta, të errta në të zezë, kafe etj. Në pamje nganjëherë ngjasojnë me rreshpet e Njësisë së Muhurr-Çajës që kanë graptolite. Në pjesën JP të planshetit shquhet struktura brahisinklinale e Malit të Sorokolit ku zhvishet një prerje potente e formacionit të Ordovikian-Silurianit (pa praninë e ignimbriteve).

Në prerjen e Sorokolit nga poshtë lartë takohen:

Më shumë se 500m alternime të përfaqësimeve litologjike të mëposhtme:

- 20-40m, horizont kuarcitesh, i cili nga gjeologët është marrë si horizont udhëzuës për kërkimin e mineralizimeve të hekurit.

  Kuarcitet paraqiten nga larg me pamje masive por në të vërtetë janë shtresë mesëm dhe shtresë hollë. Shtresat kuarcite veçohen nga njëra tjetra me rreshpe silico-sericitike, kloritike e mergelore.
- 30m, ranorë kokërrimët-alevrolite me ndërthurje rreshpore silico-sericitike, kloritike (me përmbatje shamozitike, të cilat janë emërtuar si shtresa kalimtare).
- 0.5-5m, xeheror hekuri pelitik (shamozitik-hematitik), më rrallë oolitik. Vërehet kalim gradual mbi shtresat kalimtare.
- 50 m, filitoide, silico-sericitike e kloritike, mergelore (shistet e tavanit të xeherorit të hekurit). Mes filitoideve ndahen shtresa thjerrëzore-rreshpore të gëlqerorëve me ngjyrë të murrme të zezë, shumë të pasur me makrofaunë Cephalopoda *(Ortoceratide)*. Këto të fundit i përkasin niveleve të Silurian-Devonianit por për shkak të trashësisë dhe përhapjes së kufizuar nuk i kemi veçuar në hartë. Në përgjithësi formacionet e Ordivikian-Siluarianit i janë nënshtruar një metamorfizmi të dobët.

Silurian-Devoniani (S-D)

Formacione të Silurian-Devonianit kemi veçuar vetëm në JL të Buzëmadhes në trajtë të një dalje reth 0.6 km² në tavan të formacioneve të Ordovikian-Silurianit. Përhapje të Silurian-Devonianit ka edhe në pjesë të tjera të rajonit të planshetës K-34-78-A si në Shtrez, Sorokol etj., por për shkak të sipërfaqes së kufizuar nuk janë veçuar në hartë.

Përfaqësohen nga filitoide në trajtë rreshpesh argjilo-sericitike të zeza, argjilore, rrallë mergelore etj. Jo rrallë përmbajnë thjerrëza të gëlqerorëve me Ortoceratide. Trashësia e tyre nuk i kalon 130 m.

Ashtu si formacioni i Ordovikian-Silurianit edhe formacionet e Silurian-Devonianit kanë pësuar metamorfizëm të shkallës së ulët. Ato ndërpriten nga seri damarore llamprofire dhe trupa gabrodiabazesh.

Mosha: Në gëlqerorët biomikrosparitikë, krinoidalë, që përmbajnë *Ortoceratide* është takuar aparati i konodontit *Kockelella variabilis*, formë tipike *Pridoliane* (Sliurian më i Sipërm, Meço, 1990). Në nivele më të sipërme, krahas krinoidit *Scyphocrinites sp.* janë takuar edhe konodontët: *Ozarcodina excavata excavata, O. remescheidensis remescheidenis* etj. Përhapja e formave të mësipërme është në Silurianin e Sipërm-Devonianin e Poshtëm. Në pjesën më të sipërme të prerjes kabonatike janë përcaktuar konodontet:

Ancyrodelloides ef.delta

Ozarcodina confluens

Prania e formave të mësipërme dëshmuan për moshën e Lohkoviane (Devoniani më i poshtëm).

Mesozoiku

Në planshetin K-34-78-A formacionet e Mesozoikut kanë përhapje të kufizuar në pjesën jugperëndimore dhe veriore të planshetit. Veçohen formacione të Triasikut të Poshtëm dhe Triasit të Mesëm-të Sipërm.

Triasiku i Poshtëm (T_1)

Formacionet e Triasikut të Poshtëm përhapen në kuota të larta të malësive të Sorokolit dhe Tërfojës, në pjesën jugperëndimore të planshetit. Përfaqësohen nga formime me pamje flishore ritëm hollë që ndërtohen nga rreshpet mergelore me ndashmëri petëzore e thyerje ashkëlore me thjerrëza gëlqerori rreshpor biomikrosparitik. Shkëmbi përmban grimca hidroksidesh hekurore, kristale të imët kuarci dhe përshkohen nga damarë kuarci të bardhë. Ndërpriten nga seri llamprofire dhe trupa gabrodiabazesh. Formacioni flishor shtrihet me shpëlarje dhe mospajtim strukturor nëpërmjet një pakoje të hollë konglomeratike mbi rreshpet filitike të Silurian-Devonianit dhe formacionin kuarcit-rreshpor të Ordovikian-Silurianit. Trashësia gjykohet rreth 50m por në disa vende ajo arrin deri në 120m.

Shoqërimet e konodonteve që takohen në gëlqerorët e flishit janë:

Neospathodus sp.

N. homeri

Gondolella timorensis

Format e mësipërme dëshmojnë për moshë Trias i Poshtëm. (Xhomo et al., 1985, Meço, 1988).

Mbi formacionin flishor të Triasikut të Poshtëm në pjesën JP të planshetit dhe, mbi formacione të Ordovikian-Silurianit në pjesën jugore të tij deri te Guri i Zi, shtrihen konglomerate e mikrokonglomerate ndërtuar kryesisht me zaje kuarcitesh etj. Matriksi është alevrolito-ranor i blertë dhe silico-sericitik i kuq-vjollcë. Moshën e konglomerateve e pranojmë të Triasikut të Poshtëm.

Triasiku i Mesëm-i Sipërm (T_{2-3})

Formacione të Triasikut të Mesëm-të Sipërm takohen vetëm në pjesën veriore të planshetit mes fshatrave Krushevë e Zli Potok dhe, më në verilindje.

Kemi të bëjmë kryesisht me gëlqerorë pllakorë, gëlqerorë dolomitik dhe geqlerorë të kuq nyjorë me ngjyrë gri-verdhacake deri te kuqërremtë. Pranë Zli Potokut dhe me në verilindje marrin pamje më masive. Gëlqerorët kontaktojnë tektonikisht me rreshpe të zeza të Silurianit. Pranë kontaktit tektonik gëlqerorët janë brekçëzuar. Bazuar në përvojën e gjatë të studimit të formacioneve karbonatike mendojmë që mosha e gëlqerorëve është e Triasit të Mesëm me kalime deri në Triasin e Sipërm.

Tektonika

Në pikëpamje të rajonizimit tektonik Njësia e Sharrit (Kollovozit) rezulton një njësi mbulesore që në ballin e saj është e branisur mbi Njësinë e Muhurr-Çajës ndërsa në krahët është e branisur mbi Njesinë e Abdavit në JL-L dhe mbi Njësinë e Koritnikut në VP-V jashtë territorit të planshetit tonë. Branisja ka ndodhur gjatë Eocenit më të vonshëm. Përgjithësisht, Njësia e

Sharrit ndërtohet nga struktura të qeta ku formacionet në pjesën perëndimore të njësisë kanë rënie kryesisht lindore, ndërsa në pjesën lindore kanë rënie perëndimore. Mund të thuhet pra se, në tërësi struktura e Njësisë së Sharrit është sinklinale me një përkulje të lehtë mesore dhe natyrisht me ndërlikime të rendeve më të ulëta. Në përgjithësi, nuk evidentohen struktura të përmbysura bile, edhe rëniet e shtresave janë përgjithësisht të buta dhe shumë rrallë evidentohen rënie të mëdha e shumë të mëdha të shtresave.

Përveç rrafsheve të branisjes të Njësisë së Sharrrit mbi Njësinë e Muhurr-Çajës dhe të Abdavit, në brendësi të njësisë evidentohen shkëputje ku mbizotërojnë shtrirje VP-JL, VVL-JJP, shtrirje meridionale dhe më rrallë shtrirje afro gjerësore. Në intervalin mes fshatrave Turaj dhe Shishtavec vizatohet dhe një mbihypje e kufizuar e formacioneve në drejtimin J-JP. Nga harta evidentohet qartë se mjaftë shkëputje me shtrirje VP-JL janë më të reja se rrafshi i branisjes së Njësisë së Sharrit mbi Njësinë e Abdavit. Pranë Restelicës në drejtim të Krushevës evidentohet shkëputje që ka ulur formacionet e krahut lindor dhe ka ngritur ato të krahut perëndimorë. Si rezultat kemi dhe një ndërprerje të rrafshit të branisjes së Njësisë së Sharrit mbi atë të Abdavit. Përgjithësisht evidentohen deformime me vergjencë V-P të formacioneve Paleozoike dhe Mesozoike.

Magmatizmi

Formacionet magmatike kanë përhapje të gjerë në Njësinë e Sharrit (Kollovozit). Ata përfaqësohen nga shkëmbinjtë magmatikë vullkanikë e subvullkanikë dhe nga shkëmbinjtë intruzivë e dajkorë.

Shkëmbinjtë vullkanikë dhe subvullkanikë bazikë (υ)

Përhapen gjerësisht në rajonet kufitare Shqipëri-Kosovë. Vendpërhapjet më të rëndësishme janë ato në jugperëndim të Restelicës në territorin e Kosovës dhe në Sorokol, Tërfojë, Jugu i Shistavecit, Mali i Kollovozit, etj, në territorin e Shqipërisë.

Vullkanitet bazike takohen në trajtë rrymash llavore, me trashësi deri 20-30m ndërmjet rreshpeve të Ordovikian-Silurianit dhe përgjithësisht në dysheme të vulkaniteve acide ignimbritike.

Vullkanitet bazike përfaqësohen nga bazalte, porfire bazaltike, gabrodiabaze etj, të cilat për shkak të metamorfizmit janë shndërruar në porfiritoide dhe rreshpe të gjelbra. Kanë teksturë masive deri rreshpore, mikrostrukturë bajamore, strukturë ofiolitike, poikiloofitike, porfire etj. Përbëhen nga plagjioklazi bazik dhe diopsidaugiti. Si aksesorë takohen titanomagnetiti, apatiti, etj. Në sajë të ndryshimeve takohen klorit, albit, epidot, etj.

Analizat kimike të vullkaniteve bazikë evidentojnë përmbajtje të rritutra të TiO2. Ato rezultojnë muzherite, havaite dhe toleite të mbingopura.

Shkëmbinjtë vullkanikë dhe subvullkanikë acidë (πq)

Kanë përhapje të gjerë në të dy anët e kufirit Kosovë-Shqipëri. Në territorin e Kosovës takohen në Glloboçicë e Krushevë. Në anën Shqiptare takohen në Shtrez, Kollovoz, Turaj, Shistavec, Kallabak, Kepi i Zanit, etj. Theksojmë se, në hartën gjeologjike të Kosovës në shkallë 1:200 000 (Knobloch, Legler 2006) gabimisht formacioneve ignimbritike-riolitike mes Glloboçicës dhe Krushevës, i atribuohet moshës Neogjenike. Është e qartë që, kemi formacione vullkanike-subvullkanike acide-alkalinore të moshës së Paleozoit të Poshtëm (Ordovikian-Siluriani).

Përgjithësisht kemi shkëmbinj vullkanikë, ngjyrë hiri, hiri-vjollcë, hiri-gjelbër, etj, me teksturë masive, që ndërtojnë pjesë të mesme të daljeve vullkanite dhe lloje eutaksike, me ndërtim rreshpor që ndërtojnë pjesët anësore. Kemi të bëjmë me shkëmbinj ignimbritë riolitikë deri në riolite për faciet subvullkanite (të quajtura porfire kuarcore në literaturën e vjetër). Struktura është porfire me masë themelore vitroklastike mikrofelzitike. Përbëhen nga kuarci, albi-oligoklazi, feldshpati kaliumor. Rrallë takohen copa xhami vullkanik acid, copa lavore acide dhe rreshpe kuarc-sericit-grafitike etj. Të dhënat e anlizave kimike tregojnë se ato janë shkëmbinj acid normalë, të tipit riolitik, të mbingopur në SiO2 dhe përmbajnë alkalinë. Në pjesën e poshtme të vullkaniteve acide-alkalinore takohen trahiriolite felzitike. Mes ignimbriteve takohen edhe dajka të shkëmbinjve ortofirë, ku përmbajtja e K2O arrin deri 11.3 % (Shtrez, Turaj, etj.).

Shkëmbinjtë Intruzivë (γδ)

Në shkëmbinjtë intruzivë që takohen në Njësinë e Sharrit (Kollovozit) veçohen: monzonitet, monzonite-sienitet, dioritet, granodioritet si dhe, seria e llamprofireve.

Monzonit-Sienitet, Granosienitet, Dioritet dhe Granodioritet.

Shkëmbinjtë e mësipërm dhe, lloje të afërta me to, takohen gjerësisht si masivë mes Brodit e Zli Potokut në JP të Rastelicës (dalje të vogla) dhe në veri të Kësulës së Priftit (në kufirin mes Kosovës dhe Shqipërisë). Në territorin e Shqipërisë evidentohet vetëm një dalje e kufizuar e monzonite-sieniteve në vendin mes Shistavecit dhe Malit të Kallabakut. Këto shkëmbinj intrudojnë rreshpet e Ordovkian-Silurianit, që përhapen në pjesën e sipërme të prerjes terrigjene të Paleozoikut në Njësinë e Sharrit. Kontaktet e monzonite-sieniteve dhe dioriteve me rreshpet e Silurian-Devonianit në shumë vende janë të tektonizuara. Megjithatë, formimi i glaukofanit dhe albitit në kontakt të dioriteve dhe monzoniteve me rreshpet, dëshmon për marrëdhëniet mes tyre. Dukuritë e kataklazimit dhe millonitizimit janë realizuar gjatë ngjarjeve tektonike. Në mjaft raste vërehet një transformim i dukshëm metamorfik, ku nga mineralet dominon sericiti dhe kuarci. Në raste të tjera proçeset metamorfike janë të shprehura më dobët. Në përbërjen minerale marrin pjesë në sasi të ndryshme: albiti, piroksені monoklin, biotiti, sasi të ndryshme ortoklazi dhe kuarci. Përgjithësisht në shkëmb mbizotëron masa feldshpatike e ndryshuar (albitizuar). Edhe mineralet me ngjyrë janë mjaft të ndryshuar. Në vartësi të përqindjes së SiO2, K2O etj, shkëmbi varion nga monzonit e monzonit-sienit deri në sienit e grano-sienit dhe deri në diorit, etj. Mosha e shkëmbinjve intruzivë të mësipërm trajtohet e ndryshme nga autorë të ndryshëm; Petkovski, Sikoshek (1982) japin moshë Jurasike, Knobloch, (2006) i konsideron si të Paleozoikut të Sipërm. Ne mendojmë që mosha e Jurasikut të këtyre formacioneve është më e mundëshme. Janë të nevojshme përcaktime me metodën Ar30/Ar40 dhe metoda të tjera të sakta.

Shkëmbinjtë e Serisë Llamprofire

Shkëmbinjtë llamprofirë takohen gjërësisht në VL të Zli Potokut, etj. Veçohen kersantite (kamptonite), spesartite, etj. Në mjaft raste ato mund të evidentohen në vogezite. Në përbërjen e tyre marrin pjesë: biotiti, diopsidaugiti, amfiboli, plagjioklazi, rrallë mikroklini. Si aksesorë takohen: sfeni, apatiti, etj. Plagjioklazet parqiten tepër të ndryshuara. Vogezitet, kamptonitet etj, takohen në lidhje të ngushtë me monzonitet, monzonite-sienitet, grano-sienitet, etj. Ato paraqiten në trupa me përmasa qindra metra në shtrirje dhe në relacion me monzonitet etj, janë më pak të reja. Të dhënat për moshën e shkëmbinjve të serisë llamprofire janë të varfëra. Dy përcaktime të kryera shumë vite më parë për kersantitet e Njësisë së Kollovozit japin moshë 241, 512 milion vjet, gjë që i korespondon Triasikut të Mesëm të Poshtëm. Përcaktimet janë bërë me metodën e Kalium-Argonit. Janë të nevojshme përcaktime me metodën Ar30/Ar40 dhe metoda të tjera më të sakta. Ne më shumë jemi të prirur të pranojmë moshë të Jurasikut të serisë llamprofire (ashtu si edhe për masivët intruzivë monzonitikë e dioritikë, me të cilët ato lidhen ngushtë); (shiko në kapitullin përkatës grafikët që lidhen me njësinë).

NJËSIA E ABDAVIT

Njësia e Abdavit ka përhapje të gjerë në pjesën lindore të planshetit K-34-77-A. Ajo shtrihet nga jugu i fshatit Brod, në Restelicë dhe okupon gjithë pjesën tjetër lindore deri në kufi me Maqedoninë e Veriut dhe më tej. Brenda kufijve të planshetit tonë ajo nuk takohet në territorin Shqiptar por paksa me në Jug të planshetit ajo zhvishet në lartësitë e Malit të Korabit dhe nga gjeologët Shqiptare emërtohet Njësia e Malësisë së Korabit.

Stratigrafia

Në Njësinë e Abdavit zhvishen gjerësisht formacione të Paleozoikut, depozitime të Kuaternarit dhe me pakicë formacione të Mesozoikut.

Paleozoiku

Në formacionet e Paleozoikut konvencionalisht kemi përfshirë gjithë formacionet rreshporo-karbonatike etj. me moshë të diskutueshme ?D.

Devoniani?

Formacionet e trajtuara nga ana jonë si të Devonianit (?) përfaqësohen nga formacioni i gëlqerorëve pllakorë me silicorë dhe me ndërshtresa rreshpesh argjilore-silicore dhe mbi to, rreshpe të gjlbërta me diabaze dhe gëlqerorë të mermerizuar. Në hartën gjeologjike me shkallë 1:100 000 (Petkovski, Sikoshek, 1982), këto formacione trajtohen me moshë të Triasikut të Poshtëm të Mesëm (Gëlqerorët pllakorë me silicorë si të Triasit të Poshtëm-të Mesëm ndërsa rreshpet e gjelbërta me diabaze dhe gëlqerorët e mermerizuar si të Triasit të Poshtëm të Mesëm?).

Prerje shumë të mira të gëlqerorëve pllakorë me silicorë zhvishen në Përroin e Brodit, direkt në J të fshatit si dhe në P të hotelit të Brodit. Edhe në rrjedhën e Përroit të Brodit mbi hotelin e Brodit ka zhveshje të mira. Gëlqerorët pllakorë me thjerrëza e ndërshtresa silicore kanë në pjesën e poshtme të tyre rreshpe silicore-radiolaritike të kuqe dhe me poshtë rreshpe argjilo-sericitike. Duket sikur kemi të bëjmë me formacione kabonatike të Triasikut të Mesëm, me saktë të Ladinianit, me kalimin nga radiolarite në gëlqerorë pllakorë me silicorë. Provat e kondonteve të marra në Jug dhe Veri të hotelit të Brodit nuk ofruan konodonte dhe të dhëna të tjera biostratigrafike. Edhe në Restelicë, si përgjatë rrugës mes Krushevës dhe Restelicës ashtu dhe në fshat dhe në Jug të fshatit, provat për konodonte dhe shlifet për mikrofacie të marra në gëlqerorët pllakorë me silicorë nuk dhanë rezultat me vlera biostratigrafike. Në dallim nga prerjet e Përroit të Brodit që ngjasojnë së tepërmi me formacione gëlqerore me silicorë të moshës së Triasikut, gëlqerorët me silicorë të Restelicës nuk ngjasojnë shumë me ato Triasike, ato dallojnë së pari nga prania e filiteve në tavan të gëlqerorëve me silicorë dhe si ndërshtresa mes tyre. Vetëm në JJP të Restelicës gëlqerorët ngjasojnë shumë si Triasike pasi përveç facieve të gëlqerorëve pllakorë me silicorë kemi edhe gëlqerorë të kuq nyjorë me pamje si të Anizianit. Gjithashtu, studimet petrografike dëshmojnë edhe për prani të facieve algale *(charophytie)* të laminuar me laminima algal mikrite me ngjyrë të errët, laminima algal mikrosparite/sparite (si rezultat i rikritalizimit që ka ndodhur në kohën e sedimentimit) me ngjyrë të çelët. Me sa duket laminimet e errëta, të pasur disi me lëndë argjilore, alternohen me laminimet me ngjyrë të çelët, të pasur me lëndë karbonate. Ambienti i sedimentimit është i lëvizshëm, me efekte të valëzimit të rrymave në një drejtim.

Vërehen dhe mikrostilolite, me pak hidrokside hekuri, si dhe damarë kalciti të rikristalizimit diagjenetik, gati paralel apo tërthorë me shtresëzimin/laminimin. Shlifet dhe provat e konodonteve nuk dhanë informacion biostratigrafik. Gjithashtu theksojmë se, në asnjë rast në gjithë prerjet në rrjedhjen e sipërme të Përroit të Brodit si dhe në Përroin e Restelicës në asnjë rast nuk takuam radiolarite që janë karateristike në tavan të gëlqerorëve platformikë dhe pelagjikë. Në Njësinë e Malësisë së Korabit, në mjaft prerje si në Rrafshin e Korabit, në Stanet e Preshit, Bjeshkën e Shehut, Avdanicë etj., në tavan të gëlqerorëve pllakorë me silicorë takohen radilarite të Jurasikut të Mesëm. Ky fakt, e ve edhe më shumë në dyshim moshën Triasike-Jurasike të gëlqerorëve të Brodit dhe Restelicës. Në rrjedhjen e sipërme të Përroit të Suva Rekës (Përroit të Thatë) gëlqerorët algorë paraqiten me laminim të hollë ku evidentohen alternime të laminimeve algale të kuqeremta me pak pikment hematit dhe laminime algale mikrite. Diagjeneza shprehet me kompaktësimin tepër të ngjeshur të laminave dhe litifikim të tyre me ndonjë frakturë/mikrokristali, mbushur me pak okside-hidrookside hekuri ose kalciti druzor-bllokor. Në këto gëlqerorë të Përroit të Thatë kampioni nr. 42 ofroi konodontin ***Icriodus***. Provat e marra në formacionin e gëlqerorëve pllakorë me silicorë nuk kanë ofruar të dhëna të mjaftueshme biostratigrafike për të përcaktuar saktë moshën e tyre. Petkovski, Sikoshek (1982) japin në Përroin e Brodit të dhëna të zbehta për praninë e konodonteve të Anizianit *(Neospathadus homeri dhe fragmente të Neogondobella sp.)*. Por autorët nuk saktësojnë vendin e marrjes së kampioneve dhe në bazë të asaj që ne vrojtojmë në terren vetëm në rrjedhjen me të sipërme të degëve të djathta të Përroit të Brodit përhapen formacione të vërteta të gëlqerorëve pllakorë me silicorë të Triasikut të Mesëm të argumentuara biostratigrafisht.

Janë tre mundësi interpretimi:

- Prerja të jetë e Trasikut
- Prerja të jetë e Devonianit
- Prerja të përmbajë edhe nivele të Triasikut edhe të Devonianit.

Varianti i tretë na është dukur më i pranueshëm. Variantin e tretë e mbështet dhe situata në Shqipëri. Në Njësinë e Malësisë së Korabit dhe më konkretisht në shpatin JP të Malit të Korabit dhe në Fushën e Panaireve takohen prerjet më të mira dhe të plota të formacioneve të Devonianit (Xhomo et al. 1985, Meço 1994, Hoxha 2001).

Mbi rreshpet e zeza argjilo-alervrolitore në Malin e Korabit vijojnë flishoide me thjerrëza e shtresa gëlqerorësh biomikritikë që mbajnë fragmente kriniodësh, tentakulite dhe konodontë. Janë përcaktuar tentakulitet:

Guerichina sp.

Styliolina sp.

Novakia sp.

Viratellina sp.

Striatostyliolina sp. etj.

Format e mësipërme kanë përhapje në Devonianin e Poshtëm dhe të Mesëm (Emsian-Zhivetian).

Janë përcaktuar edhe konodontet:

Icriodus steinachensis

Polygnathus serotinus

P. aff. laticostatus

P. linguiformis

Bellodela sp. etj.

Mosha Emsian-Zhivetian.

Në rreshpet me ndërshtresa gëlqerorësh në Fushën e Panaireve, krahas tentakuliteve dhe konodonteve të mësipërme takohen edhe:

a. bivalvorë:

Paraptyx cf. uchtensis

Ontaria cf. concentrica

Pseudoriculopecten sp.

Paracacardium sp.

b. Cefalopode:

Sichuanoceras ef. leipoense bitaunioceras sp.

Miclulinoceras sp etj.

Të gjitha format e mësipërme kanë përhapje kryesisht në Silurian por ndeshen edhe në Devonian (Melo 1969). Mbi rreshpet me shtresa gëlqerorësh vijojnë gëlqerorët e Malit të Korabit biomikrosparitikë, me ndërshtresa filitesh. Në gëlqerorët janë takuar tentakulite të gjinisë:

Styliolina, Krinoide Salairocrinus sp., cefalopode Michelinoceras sp.

si dhe konodontet:

Polygnathus linguiformis

P. aff. pseudofoliatus

Tortuodus kockelianus australis

Ozarcodina sp etj.

Të gjitha format e mësipërme dëshmojnë për moshën e Devonianit të Mesëm (Eifelian-Zhivetian).

Në gëlqerorët e kreut të prerjes janë takuar:

Palmatolepsis disparilis

P.minutisima etj.

Këto forma i përkasin majës së Devonianit të Mesëm dhe Devonianit të Sipërm. Nga sa më sipër argumentohet plotësisht prania e formacioneve të Devonianit në Njësinë e Malësisë së Korabit.

Por, në Njësinë e Malësisë së Korabit krahas formacioneve të Devonianit janë përcaktuar konodonte të Triasikut të Mesëm të Sipërm në gëlqerorë mbi ato të Devonianit.

Nisur nga kjo analogji, ne mendojmë që alternativa e tretë për Njësinë e Abdavit është më e mundshmja.

Me qenë se (sikundër do e trajtojmë më poshtë), në këtë njësi është argumentuar i sigurt niveli i Triasit të Mesëm vetëm në lartësitë e maleve të Sharrit mendojmë që datimi si i Devonianit me pikëpyetje i gëlqerorëve pllakorë me silicorë të prerjeve të poshtme është më i pranueshëm.

Krahas gëlqerorëve pllakorë me silicorë në Njësinë e Abdavit takohen edhe rreshpe të blerta me ndërshtresa diabazesh dhe porfirite diabazike. Kemi të

bëjmë me rreshpe epidot-aktinolitike, kuarc-epidotike, epidot-kloritike, albit-epidot-kloritike, ranorike etj.

Marrëdhëniet, mes gëlqerorëve pllakorë me silicorë dhe rreshpeve të gjelbërta e diabazeve, janë tektonike, me shumë ndërlikime ku, është i pa mundur veçimi i tyre pa punime të rregullta rilevimi. Është kjo arsyeja që në hartë i kemi paraqitur të pandarë dhe i kemi datuar si Devonian me pikëpyetje.

Po japin një përshkrim të formimeve Devoniane në njësinë e Malësisë së Korabit në shërbim të idesë së pranisë së këtyre depozitimeve edhe në pjesën Kosovare të emërtuar si Njësia e Abdavit.

Depozitimet Devoniane të Njësisë së Malësisë së Korabit përhapen në shpatin JP të Malit të Korabit dhe, në Fushën e Panaireve takohen prerjet më të mira e më të plota të depozitimeve Devoniane të Zonës së Korabit.

Mbi rreshpet e zeza argjilo-alevrolitore në Malin e Korabit, vendoset një pako e ndërthurjes së imët flishoidale, ranore feldshpatike e kuarcore kokërr imët dhe, rreshpe argjilore sericitike deri alevrolitike me ngjyrë hiri të errët. Afërsisht, në pjesën e mesme të kësaj pakoje, takohen dhe shtresa e thjerrëza të gëlqerorëve biomikritikë, hiri e hiri të errët që përmbajnë fragmente krinoideash, tentakulitesh e konodontesh. Në pjesën e sipërme të pakos takohen shtresa të vullkaniteve bazikë si dhe damarë të llamprofireve, në përgjithësi shumë të ndyshuar.

Po ashtu, në rreshpet e kësaj pakoje takohet dhe një trup i shkëmbinjve ultrabazikë të trajtuar si pikrite. Në Fushën e Panaireve ruhet pak a shumë e njëjta preje, vetëm se në pjesën e sipërme takohen dhe dy horizonte ranorësh hiri në të blertë, që në shtrirje të tyre kalojnë në mikrokonglomerate e konglomerate. Mbi rreshpet me shtresa gëlqerorësh që përshkruam në Malin e Korabit, vendosen gëlqerorët e Korabit që në pjesën e poshtme ndërtohen nga një pako gëlqerorësh biomikrosparitikë, me horizonte thjerrëzore të rreshpeve argjilore me shtresa thjerrëzore të gëlqerorëve biomikritikë e biomikrosparitikë me krinoidë, tentakulite, cefalopodë e konodonte.

Triasiku i Mesëm-Jurasiku i Mesëm (T_2-J_2)

Formacioni i Triasikut të Mesëm-Jurasikut të Mesëm përhapet vetëm në cepin lindor të planshetës në rrjedhjen më të sipërme të Përroit të Brodit. Përfaqësohet nga gëlqerorë pllakorë dhe bankorë me ndërshtresa e thjerrëza silicore. Në nivelet e sipërme gëlqerorët bëhen mergelore dhe kalohet në rreshpe të gjelbërta-vjollcë me ndërshtresa gëlqerorësh të kuqërremtë, rrallë edhe me konglomerate. Paraqitën të mermerizuar dhe në disa raste të dolomitizuar.

Në këto gëlqerorë, në vazhdim verilindor të tyre, në vendin e quajtur Kësula e Priftit (Popova Shapka), janë përcaktuar konodontet:

Epigandolella abneptis

Paragondolella navicula

Paragondolella polygnathiformis

Paragolella sp. etj.

Format e mësipërme të konodontëve dëshmojnë për moshën e Triasit të Mesëm. Ne mendojmë që vazhdimësia formacionale e gëlqerorëve pllakorë me silicorë, që kalojnë me sipër në gëlqerorë mergelorë dhe rreshpe të gjelbërta-vjollcë me gëlqerorë të kuqeremtë, mund të kalojë deri në Jurasik të Mesëm. Situata analoge evidentohen në dhjetëra prerje në Shqipëri në formacionet pelagjike në periferinë perëndimore dhe lindore të ofioliteve. Edhe në vetë njësinë tektonike të Malësisë së Korabit, sikundër theksuam më sipër, si në prerjet e Rrafshit të Korabit ashtu dhe në Stanet e Preshit dhe Bjeshkën e Shehut, formacionet karbonato-silicore janë të moshës së Triasit të Mesëm-Jurasikut të Mesëm dhe mbi to vijojnë formacione silicore-terrigjene të Jurasikut të Mesëm të Sipërm (Hoxha, 2001). Vetë gëlqerorët pllakorë aq me tepër të mermerizuar nuk japin informacione biostratigrafike për mikrofauna udhëheqëse të Triasikut të Sipërm dhe Jurasikut të Poshtëm-të Mesëm. Krahas provëmarrjes më të dendur për konodonte duke u orientuar në tavan në ndërshtresat e gëlqerorëve me bivalvia pelagjike që janë mjaftë premtuese për gjetjen e konodonteve duhen kërkuar në shtresat turbiditike të cilat ofrojnë mundësi shumë të mëdha për informacion biostratigrafik me foraminiferë etj. Nga trajtimi që i bëmë Devonianit? dhe Triasikut të Mesëm-Jurasikut të Mesëm, evidentohet që në evolucionin paleogjeografik të Njësisë së Abdavit kanë mbizotëruar kushtet neritike dhe pelagjike të sedimentimit. Ashtu si analogia e saj në Shqipëri, Njësia e Abdavit nuk ka asnjë element nga trajtimet që rendomë i bëhet mikroblokut Korab-Pelagonian si një trevë vetëm me evolucion platformik.

Njësia e Abdavit së bashku me Njësinë e Malësisë së Korabit, kanë përfaqësuar gjatë Devonianit deri në Jurasikun e Mesëm, një basen me sedimentim kryesisht neritik gjatë Devonianit? dhe pelagjik gjatë Triasikut-Jurasikut. Bile, në të dy njësitë nuk evidentohet as formacioni konglomeratik i Verrocanos që fletë për një cektëzim të basenit gjatë Permo-Triasikut të hershëm.

Tektonika

Njësia tektonike e Abdavit në drejtimin lindor vazhdon në territorin e Maqedonisë së Veriut ndërsa në drejtimin perëndimor dhe veriperëndimor i nënshtrohet tektonikisht Njësisë tektonike të Sharrit. Rrafshi i branisjes së Njësisë së Sharrit mbi Njësinë e Adbavit është tektonika kryesore e gjysmës lindore të planshetit.

Në bazë të vrojtimeve tona të kryera në luginën e Përroit të Brodit dhe të Restelicës rezulton se shtrirja e formacioneve gjeologjike karbonatike dhe rreshpeve është përgjithësisht e qetë, me kënde të buta deri mesatare të shtrirjes. Nuk evidentohen struktura të përmbysura në rajon, në të kundërtën ato formojnë brahirrudha pozitive apo negative të ndërlikuara nga shkëputje afro vertikale që i japin rajonit një ndërtim bllokor. Shkëputjet kanë drejtim VL-JP dhe VP-JL. Në rajon është e vështirë të evidentohen marrëdhëniet mes dy drejtimeve të shkëputjeve por përgjithësisht shkëputjet me shtrirje verilindore janë më të reja se ato me shtrirje veriperëndimore.

Për sa i përket vazhdimësisë së Njësisë së Abdavit poshtë njësisë së Sharrit dhe, marrëdhënieve te saj me Njësinë e Muhurr-Çajës, mendojmë se duhet të pritet një mbivendosje e Njësisë së Abdavit mbi atë të Muhurr-Çajës por, nuk përjashtohen edhe kalime mes tyre si dy njësi me evolucion qartësisht pelagjik, ku Njësia e Muhurr-Çajës do të përbënte pjesën perëndimore dhe Njësia e Abdavit pjesën lindore.

Magmatizmi

Në Njësinë e Abdavit formacionet magmatike kanë përhapje relativisht të kufizuar. Shkëmbinjtë magmatikë më të vjetër janë gabrodiabazet që shoqërojnë formacionin e shisteve të gjelbërta të ?Devonianit. Kemi të bëjmë me gabrodiabaze dhe diabaze të metamorfizuara dhe të rreshpëzuara. Vërehen gabrodiabaze me strukturë kristaline ku evidentohen pirokseni, aktinoliti dhe kloriti. Vërehen dhe relike të plagjioklazit. Me pakicë kanë apatit dhe kokrriza mineralesh metalore. Mosha e gabrodiabazeve, ashtu si dhe e vetë formacionit karbonato-silicor dhe rreshporo-diabazik është e diskutueshme.

Nuk përjashtohet mundësia që mosha e gabrodiabazeve të jetë e Triasikut ose e Jurasikut. Nevojiten të dhëna plotësuese për të patur një interpretim më të bazuar. Në pjesën JL të planshetit, në Njësinë e Abdavit në Përroin e Gurit të Zi, zhvishet një masiv granodioritik me sipërfaqe rreth 2. 5 km^2. Ai lokalizohet mes formacioneve të rreshpeve të gjelbërta me diabaze dhe mbulohet gjerësisht nga depozitimet morenore të Kuaternarit. Granodioritet përbëhen nga minerale të kuarcit, feldshpatit, biotitit dhe amfibolit. Paraqesin kataklazime të shumta gjë që kushtëzohet edhe nga pozicioni i tyre pranë ballit të branisjes së Njësisë së Sharrit mbi Njësinë e Abdavit. Granodioritet e Përroit të Gurit të Zi ngjasojnë shumë me granitet, granodioritet e granosionitet e Staneve të Preshit që takohen në Njësinë e Malësisë së Korabit (Tabela 1). Këto të fundit ndërpresin gëlqerorët e Devonianit dhe formacionet karbonato-rreshpore Triasiko-Jurasike të Staneve të Preshit. Në granodiorite takohen ksenolite të formacioneve të mësipërme. Petkovski, Sikoshek (1982), i konsiderojnë granodioritet e Gurit të Zi të moshës së Jurasikut. Edhe Castorina et al. (1995), Beqiraj et al. (1997), duke analizuar shkëmbinjtë granodiorite me metodën e Rb/Sr japin një moshë 186 ± 9 milionë vjet që i përgjigjet gjithashtu Jurasikut. Edhe prova të moshës absolute të shkëmbinjve granitoidë të Shqipërisë me metodën e K-Ar japin një moshë absolute të tyre në kufijtë 165 ± 4 deri 175 ± 6

milionë vjet që gjithashtu i korrespondon Jurasikut. Kushtet e vendosjes gjeologjike të masivëve granodioritë i përgjigjen konsolidimit të tyre në thellësi relativisht të vogla në një mjedis tipik kontinental. Ato janë formuar nga kristalizimi i shkrirjeve silikate acide të serisë normale kalçium-alkalinore deri në mbialkalinore. Natyra kalcium-alkalinore e granodioriteve kontinentale, bollëku në elementët higomagmatikë të normalizuar kundrejt graniteve të kurrizoreve oqeanike dhe për ngjashmëri me kimizmin e shkëmbinjve acidë të buzëve kontinentale aktive (tipi i Andeve), sipas Beqiraj et al. (1997), magmat primare të këtyre graniteve kanë rrjedhur nga shkrirja parciale e kores së poshtme ose i janë nënshtruar një kontaminimi intensiv në korën e sipërme (Xhomo et al., 2002).

Nr. Rendor	Komponentët e analizuar	Përroi i Gurit të Zi Granodiorit	Stanet e Preshit Granit	Stanet e Preshit Granosienit
1	SiO2	64.88	68.20	61.06
2	TiO2	0.37	0.40	0.30
3	Al2O3	18.57	15.98	18.92
4	Fe2O3	1.40	0.52	0.76
5	FeO	0.60	3.12	2.30
6	MnO	0.03	0.05	0.10
7	MgO	1.06	2.38	1.33
8	CaO	2.38	0.05	1.66
9	Na2O	4.05	3.84	6.40
10	K2O	5.30	4.31	4.90
11	P2O3	0.24	2.12	1.34
12	H2O+	1.02	-	0.40
13	H2O-	0.02	1.47	0.04
14	Shuma	99.92	102.44	99.51

Tabela 1. *Analizat kimike të Granodioriteve të Përroit të Gurit të Zi dhe Staneve të Preshit në %.*

Shënim:

Analizat laboratorike për formacionet magmatike kryesore u realizuan në laboratorin e CRPG në Nansi (Francë).

Analizat e konodontëve u studiuan nga prof. S. Meço, ato mikropaleontologjike nga prof. A. Pirdeni dhe ato petrografike nga prof. P. Theodhori.

Disa rekomandime:

- Të vazhdojnë hulumtimet për të saktësuar moshën e formacioneve karbonatike-rreshpore e radiolaritike të Njësisë së Abdavit në se ato i përkasin Devonianit apo Triasikut (apo, mos ndoshta i kemi të dy moshat?).
- Të bëhen studime të imtësuara stratigrafike e paleontologjike në njësitë përkatëse në territorin e Kosovës, veçanërisht në atë të Abdavit, të trajtuara nga ana jonë, për të qartësuar më tek korrelimet gjeologjike.
- Në të ardhmen duhet të kryhen punime të detajuara rilevimi në shkallë 1:25 000, të cilat do të sqarojnë jo vetëm gjeologjinë tepër të komplikuar të rajonit por, dhe perspektivën mineralmbajtëse të tij, kryesisht për mineralet e hekurit, manganit, ato radioaktive dhe mineralet jo metalorë.

Referencat

Anonim (1974). Geolloshka-Tektonska karta Kosovo. Sc. 1:100 000.

Arsovski M. (1997). Tektonika na Makedonia, Stip, 1997.

Barth A., Legler C., Hoffman B., Kühne H., Maliqi G., Peci N. (2006). Map of Mineral of Kosovo. Sc. 1:200 000. KPM, Prishtinë.

Beqiraj A., Castorina F., Garbarino C., Masi U., Mignardi S., and Nicoletti M. (1997). Further geochemical evidence of the Jurassic margin of the Balcan continent. Abstract Sopplement, No 1, Terra Nova Volume 9, Strazbourg, p462.

Bushi E., Caka B., Hoxha V., Kodra A., Theodhori P., Tashko A., Qirici V., Kati P., Kospiri A., Manjani E., Pirdeni A., Gjokuta D., Meshi M., Kulla M., Shashaj A. (1979). "Studim tematiko-përgjithsues e rilevues kompleks për sqarimin e perspektivës hekurmbajtëse të pjesës qëndrore të zonës së Korabit dhe konkretizimi i një vendburimi hekuri pa nikel." Tiranë. Arkivi Qendror i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.

Bushi E., Kodra A., Cakaj B., Hoxha V., Manjani E., Pirdeni A. (1982). Gjeologjia dhe hekurmbajtja e rajonit Bushtricë-Ploshtan. Bul. i Shken. Gjeologjike, Nr. 1, 101-113.

Castorina F., Garbarino C., Masi U., Mignardi S., Nicoletti M. and Beqiraj A. (1995). The granitic of Fierza (North-Eastern Albania): Geochemical evidence of the Jurassic margin of the Balcan continent. Special Publikcation of the Geological Society of Greece. No 4/2, 664-672.

Elezaj Z., Kodra A. (2008). Gjeologjia e Kosovës. U.P. 293 f.

Kossmat F. (1924). Geologie der zentrales Balkanhalbisnel. Borntrager (ad).

Kodra A. (1981). Shkëmbinjtë Jurasikë dhe Jurasiko-Kretakë në rajonet verilindore të Albanideve (në verilindje të ofioliteve të zonës Mirdita). Përmbledhje Studimesh Nr. 4. Tiranë.

Kodra B., Alliu I., Hoxha V., Meshi N., Kolgjini E., Mazreku A., Kospiri A. (1986). Studime tematiko-përgjithësuese e rilevuese komplekse për sqarimin e perspektivës së mineralizimeve të hekurit dhe mineralizimeve të tjera në rajonin e Radomirës. f. 78. Arkivi i ISPGJ, Tiranë.

Legler D., Teichman D., Pruthi V. (2003). Harta Gjeologjike e Kosoves (1:200 000).

Hoxha V. (2000). Harta gjeologjike dhe e pasurive minerale të rrethit Dibër në shkallën 1:50 000, me tekstin shpjegues përkatës. Arkivi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, Tiranë.

Hoxha V. (2001). Tiparet themelore të gjeologjisë dhe perspektiva e kërkimeve në rajonin Kërçisht-Sorokol. Disertacion. Universiteti i Tiranës.

Hoxha V., Xhomo A., Onuzi K. (2007). Raport shkencor (Studim) i projektit të koduar III-1 me temë: "Korrelime gjeologjike të planshetave 1: 50 000 të Shqipërisë, plansheti Peshkopia". Arkivi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, Tiranë.

Mekshiqi N., Hoxha V. (2007). Raport shkencor i projektit të koduar III-14 me temë: Vrojtime në terren rreth lidhjes dhe unifikimit të prerjeve dhe kolonave gjeologjike të njësive kryesore litostrtigrafike dhe metalogjenike mes Shqiperisë dhe Kosovës. Arkivi i Sherbimit Gjeologjik Shqiptar, Tiranë.

Melo V., Aliaj Sh., Kodra A., Xhomo A., Naço P., Lulo F., Gjata K., Hoxha V. (1991). Dritare tektonike të zonave të jashtme në rajonet lindore të Albanideve.¬ Buletini i Shkencave Gjeologjike, Nr. 1, Tiranë.

Meço S. (1984). Rreth pranisë së niveleve konodontmbajtëse të depozitimeve Paleozoike e Triasike të zonës së Korabit. Buletini i Shkencave Gjeologjike, Nr. 2. Tiranë.

Meço S. (1987). Konodontët e kufirit Silurian-Devonian në disa prerje të zonës së Korabit. Buletin i Shkencave Gjeologjike, Nr. 4.

Meço S. (1988). Mbi moshen e facieve triasike në zonën e Korabit të përcaktuara me anën e konodonteve. Buletini i Shkencave Gjeologjike, Nr.2.

Meço S. (1988). Konodontet dhe stratigrafia e depozitimeve paleozoike dhe triasike të Zonës së Korabit. Disertacion, 276 pp, 65 figura, 7 tabela. FGJM, Tiranë.

Meço S. (2010). Litho-biostratigraphy and the conodonts of Palaeozoic/Triassic deposits in Albania. Palaeontograhica, Abt. A, Palaeozoology-Stratigraphy, 290, 4-6, 131-197.

Meço S. (2011). Konodontet dhe vlera e tyre në stratigrafinë e Shqipërisë. Buletini i Shken-cave Gjeologjike, Nr, 2, 47-58.

Meço S. (2020). "Revolucioni" Konodontik në Stratigrafi. Buletini i Shkencave Gjeologjike. Nr. 1, faqe 92-101.

Meha M. (2000). Hartografia, Tekst universitar. FSHMN, Prishtina.

Meha M. (2006). KOSOVAREF 01, Libër, Botues Agjencioni Kadastral i Kosovës.

Petkoviç P., Temkova V. (1980-1981). Razvitje paleozika na N. R. Makedonija. Vjesnik.

Panqerovski J., Haxhidimitrova S. (1975). Geolloshka karta S.R. Makedonija. Shk. 1:200 000 (në 2 fletë).

Petkovskij P., Sikoshek B. (1982). Geoloshka karta (1:100 000) i tumaç za list Gostivar, K-34-78.

Pashko P. (1990). Zonat graptolitike landoveriane në zonën e Çajës (Zona e Korabit), Buletini i Shkencave Gjeologjike, Nr. 1, Tiranë.Geolog. Kn. 38/39, Ser. A.

Theodhori P., Qirici V. (1982). Rreth prerjes së formimeve Paleozoike, petrografike dhe kushteve të formimit të xeherorit hekuror në pjesën qendrore të zonës së Korabit. Buletini i Shkencave Gjeologjike, Nr. 2. Tiranë.

Xhomo A., Pashko P., Meço S. (1985). Stratigrafia e depozitimeve paleozoike e triasike të zonës së Korabit. ISPGJ, f. 215, Tiranë.

Xhomo A., Pashko P., Meço S. (1987). Stratigrafia e depozitimeve siluriane të zonës së Korabit. Buletini i Shkencave Gjeologjike, Nr. 3, 119-128.

Xhomo A., Kodra A., Shallo A. (2002). Harta gjeologjike e Shqipërisë në shkallë 1:200 000 (Botim i vitit 2005).

GEOLOGICAL CORRELATIONS OF THE KOSOVO-ALBANIA BORDER AREA (SHEET K-34-78-A, SHISHTAVECI, Scale 1: 50 000)

Vesel Hoxha*, Alaudin Kodra*, Sabri Avdullahi **

Keywords: *Sharri, Abdavi, paleozoi, magmatizëm, tektonikë, konodont.*

The geology of the area largely consists of the Paleozoic formations of Ordovician-Silurian, Silurian-Devonian, Devonian?, Permian-Triassic, Triassic-Jurassic and Quaternary deposits that are mainly moraines.

In the territory of Kosovo for the first time, the tectonic units of Sharri and Abdavi, that correspond to the tectonic units of Kollovozi and Malësia of Korabi in the territory of Albania, are distinguished. In the western part of the map sheet, the tectonic unit of Muhurr-Çaja is observed.

In the Sharri Unit, in contrast to previously published maps, the formations dated to the Permian-Triassic or the Devonian, or as of the Late Paleozoic, by us are argued to be of Ordovician-Silurian and are correlated very well with the formations of the same age in the territory of Albania. The Sharri tectonic unit for the first time is treated like tectonically overthrusted on its border units.

For the Abdavi unit, unlike the previously published maps, the formations dated both Early-Middle Triassic and Late Paleozoic, with slimmer fauna data are interpreted as of the Devonian age (!?).

The Ignimbritic-Rhyolitic Monzonitic-Syenite, Granosyenite magmatism and Lamprophyre series, etc., are correctly identified with their whole rock analysis of major elements, trace elements and rare earth ones. In the presented map, a good correlation of border formations on both sides of the Kosovo-Albania border, has been implemented.

The purpose of the study was to carry out the correlation of the geological formations of the border areas in question, clarifying the geological problems reflected in maps of different scales compiled for the regions on both sides of the border and to build a new tectonic regionalization, based on the correlating results.

The earliest studies in the area and beyond belong to A. Boue (1836-1864) and Visquenel (1844). K. Oestereich (1902) treats the shales and marbles of the Mali i Thate sector as of the Paleozoic (Suva Gora). Nikolic (1912) and Smilanic (1929), give geological data for the region and especially for the glacial deposits of the Sharri and Korabi Mountains.

Kossmat (1924), Nopsca (1929), Kober, Gripp (1922), Tukan (1934), contribute to the increasing of the recognition of the regions of the occurrence of the Paleozoic formations. Heritsch (1934) in Qafa e Kadise and other sites in the east of our area, describes coral and orthoceras fragments belonging to the Silurian-Devonian age.

Petkovski, Sikoshek (1982) provide in detail studies conducted up to the year 1975 in the K-34-78 (Gostivar) map sheet and neighboring areas. On the 1975 map of Kosovo at scale 1: 100 000 compiled by Croatian specialists, in the K-34-77 map sheet area, shales and marbles of Paleozoic, phyllites of Paleozoic and other formations, are given.

At the sector of the upper flow of Perroi i Brodit stream, formations of Late Cretaceous are mapped, but since our verification this does not respond to the reality as they are Devonian formations?. It is worthwhile to note that the Sharri unit's formations are highlighted in this map, separated by us from the formations of the Abdavi unit, distinguished also by us, but that are interpreted by them without thrusting.

The authors represent very well the acid-alkaline magmatic formations of the area. Petkovski, Sikoshek (1982) on Map 1: 100,000 of the K-34-77 map sheet (Gostivari) and its explanatory text, all formations of the unit separated by us as the Abdavi unit, treat them as of the Triassic.

**UPT, IGJEUM, Tiranë; **Un. Isa Boletini, Fakulteti i Gjeoshkencave, Mitrovicë*
e-mail: vesel.hoxha@gmail.com; veselhoxha52@yahoo.com

They consider the Sharri unit formations as of the Devonian and Permian-Triassic ages. As we will explain on the text and present on the map these are mainly ordovician- silurian formations. It is interesting to note that the authors consider the acid-alkaline magmatic formations of the region (diorites, granodiorites, granosienites, etc.) to be of the Jurassic age, which is also consistent with the data of the absolute age of the granodiorites of the Stanet e Preshit area in Albania.

Knobloch, Legler (2006), consider all the schistous, quartzous and carbonate formations of the K-34-78 map sheet as of the Late Paleozoic by completely eliminating Triassic and not treating at all the Early Paleozoic formations. On the geological map in scale 1: 50 000 of German authors (obtained from ICMM), the treatments are made in accordance with Petkovski, Sikoshek (1982) map.

The area is part of the Korabi tectonic zone, as part of Microblock Korabi-Pelagonian (Fig. 1, 2, 3, 4 and 5).

In the region are separated:

- Sharri tectonic unit, with its equivalent in Albania, the Kollovozi unit.
- Abdavi tectonic unit, with its equivalent in Albania, the Malësia e Korabit unit.
- Muhurri-Çaja tectonic unit. It occurs only in the territory of Albania.

In the description of stratigraphy, tectonics and magmatism for each unit are given data on the territory of Kosovo and relevant correlations with the formations and the structures of the same ages in the Albanian territory.

Kollovozi subzone is mainly composed by Ordovician deposits and less by those of Silurian-Devonian. Triassic deposits have limited outcrop at Mali i Sorokolit and overly with unconformity on Silurian-Devonian formations. Magmatism, in addition to acide volcanic rocks, is also expressed by scarse layers of diabases, gabrodiabases and minettes.

Muhurri-Çaja subzone extends like a strip, west of Malesia e Kollovozit. This unit has represented a trough, beginning from Silurian.

Among the Paleozoic deposits, the clayey and clayey-siliceous black shales with graptolites of Llandoverian, Wenlockian and Landovian, predominate (Xhomo, 1985; 1987; Qirici, 1982). The graptolite study has recently led to the separation of many biozones (Pashko, 1987; 1988; 1989).

Above the Silurian deposits, the Devonian ones are placed, and at the bottom the Lohkovian ones in Muhurr and contain graptolites. Magmatism is expressed by mafic volcanic rocks, often with alkalinic affinity, with tuffs, tuffites, monzonites and minettes.

The Malësia e Korabit subzone, in the deeper parts of its section is represented by clayey and alevrolite shales, which at their bottom, are of Silurian. Above, the section is transformed into schistous formations with limestone layers with tentaculites, crinoides, cephalopods, etc, that step by step pass to the limestones of the Korabi Mountain of Early-Middle Devonian.

At the sectors of the Bjeshka e Shehut, Stanet e Preshit and Stanet e Zonjave, at the lower part, the sandy-conglomerate terrigeenous deposits with shales and carbonates and then the clayey-carbonate and volcanic rocks, predominate. The determined conodontes testify that these deposits belong to almost entire Triassic.

This subzone, in the northern sectors, is overlain by the deposits of the subzones of Kollovozi and Muhurri and, together with these, overthrust and overlain the evaporites domes of Peshkopia and the flyschoidal rocks of Tithonian-Late Cretaceous and Paleogene that surround the evaporites domes.

The Sharri unit is widespread at the western part of the territory of Kosovo (at the borders of this map sheet) and occupies almost entirely the part of the territory of Albania. In the territory of Kosovo, it extends from Brodi, Zli Potok and Kruseva in the north, to the Kesula e Priftitt and at the upper flow of the Radica River, in the south.

In the territory of Albania, it includes the villages of Shishtaveci, Novoseja, Shtrezi, Topojani and Brekija in the north, till to the Malesia e Sorokolit in the south. In available geological maps there are obvious discrepancies, especially in the age of the formation. Here are distinguished the formations of Paleozoic, Mesozoic, and

Quaternary (Ordovician-Silurian (O-S), Silurian- Devonian (S-D), Early Triassic (T1), Middle-Late Triassic (T2-3), Quaternary Q).

It turns out a covering unit that in its forehead is overthrusted on the Muhurri-Çaja unit while its flanks are overthrusted on the Abdavi unit in SE-E and on the Koritniku unit in NW-N, outside the territory of our map sheet. Thrusting has occurred during the Later Eocene.

Magmatic formations are very widespread.

They are represented by mafic volcanic and subvolcanic rocks (υ), felsic volcanic and subvolcanic rocks (πq), from intrusive rocks (γδ) monzonite-syenites, granosyenites, diorites and granodiorites.

Lamprophyre rocks are widely present in NE of Zli Potok, etc. Kersantites (kamponites) and spessartites, prdominate.

Abdavi's unit has extensive spread in the eastern part of the K-34-77-A map sheet. It stretches from the south of Brodi village to Restelica and occupies the entire eastern part to the border with North Macedonia and beyond.

Within the boundaries of our map sheet, it does not occur in Albanian territory but slightly more in south of the map sheet, it crops out in the heights of Korab mountain and from the Albanian geologists, it is named the Malesia e Korabit unit.

Here, the outcrops of formations of Paleozioc and of Quaternary predominate and the ones of Mesozoic (T2-J2) are less frequent.

In the formations of Paleozoic we have conventionally involved all schistous-carbonate formations with controversial age?D. The formations considered by us as of Devonian (?) are represented by the formation of sheeted limestones with cherts and with intercalations of clayey-cherty shales and over them, green shales with diabases and marbled limestones.

There are three options of interpretation:

- Section to be of Triassic
- Section to be of Devonian
- Section to also include Triassic and Devonian levels.

The third option seems to be more acceptable. The third option is supported by the situation in Albania.

At the unit of Malësia e Korabit and more specifically at the SW slope of Mali i Korabit and at Fusha e Panaireve, the best and the most complete sections of the formations of Devonian, occur (Xhomo et al. 1985, Meço 1994, Hoxha 2001).

Abdavi's tectonic unit in the eastern direction continues in the territory of the North Macedonia, while in the western and northwest direction is tectonically overlain by the tectonic unit of Sharri. The overriding plane of Sharri unit over the Adbavi unit is the main tectonic of the eastern half of the map sheet.

Regarding the continuity of the Abdav Unit under the Sharri unit and its relations with the Muhurr-Çaja Unit, we think that an overlap of the Abdav Unit over that of the Muhurr-Çaja should be expected, but there are not excluded transitions between them, like two units with clearly pelagic evolution, where the Muhurr- Çaja unit would be the western part and the Abdavi unit the eastern part.

In the Abdavi unit, magmatic formations have relatively limited occurrence. The oldest magmatic rocks are the gabbrodiabiabases that accompany the formation of green schists of ?Devonian.

In the SE part of the map sheet, at the Abdavi unit in the stream of Guri i Zi, a granodiorite massif occupying some 2.5 km^2, crops out. It is located between the formations of green schists with diabases and is widely covered by quaternary moraines.

Granodiorites of the stream Perroi i Zi resemble a lot with granites, granodiorites and granosyenites of Stanet e Preshit that occur at the Malësia e Korabit unit (Tab. 1).

Some Recommendations:

- To specify the age of carbonatic-schistous and radiolarian formations of the Abdavi unit if they belong to the Devonian or Triassic (or perhaps there are both ages?).
- To compile detailed stratigraphic studies associated with paleontological studies in the respective units in the territory of Kosovo, especially in the one of Abdavi, to further clarify geo-

logical correlations.

- In the future, detailed works of geological mapping, scale 1:25 000, should be compiled which will clarify not only the highly complicated geology of the region concerned, but also and its mineral perspective, mainly for iron, manganese, radioactive minerals, and nonmetallic minerals.

PERSPEKTIVA KROMMBAJTËSE E VENDBURIMIT TË BULQIZËS, NË VERI TË LUGINËS SË VAJKALIT

Dashamir Gega*

Abstrakt

Vrojtimet fushore të kryera në kuadër të studimit të kromit nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (2019, 2020, 2021) në masivin e Bulqizës tregojnë se Lugina e Vajkalit është fenomen gjeotektonik, ku ndërthuren tektonikat shkëputëse të vendosura në krah të luginës së Vajkalit (takuar në sipërfaqe dhe në traverbankun e Kreshtës e në traverbankun e Shëngjunit, me shtrije sipas zgjatjes së luginës dhe rënie juglindore (kontakti jugor) dhe veriperëndimore (kontakti verior)), me proceset deformuese të masivit të cilat vazhdojnë dhe sot e shprehur kjo me krijimin e shtresëzimit shkëmbor magmatik i cili shkon paralelisht me morfologjinë e relievit. Në artikull jepen ide të reja të pa trajtuara me parë mbi zhvillimin e vendburimit të kromit Bulqizë-Batër në veri të luginës së Vajkalit.

Fjalët kyç: *Lugina e Vajkalit, niveli kromitik, Bulqizë-Batër, shtresëzimi shkëmbor magmatik.*

Hyrje

Niveli kromitik i vendburimit Bulqizë-Batër lokalizohet në facien harcburgit-dunitike (sekuenca tektonike) dhe përbën nivelin kryesor mineralmbajtës dhe me të rëndësishëm në aspektin ekonomik. Zhvillohet në shtrirje deri ne 5000 ml dhe në rënie 500-2000 ml .

Punimet gjeologo-minerare, galeritë e Kreshtës (H-1050 m, H-1100 m) si dhe punimet e shpimit nga nëntoka dhe sipërfaqja, të kryera nga viti 1980 deri me 1996 nuk kanë marrë rezultate pozitive mbi zhvillimin e mineralizimit të vendburimit Bulqizë-Batër, në veri të luginës së Vajkalit. Përgjithësimi i punimeve të kryera ndër vite (1980-1996) si dhe vrojtimet e detajuara fushore të kryera në kuadër të studimit të kromit, ndërmarrë nga Shërbimi gjeologjik Shqiptar (Gega et al., 2020) japin të dhëna të reja mbi mundësinë e zhvillimit të mineralizimit në veri.

Evolimi i mendimit gjeologjik mbi perspektivën e vendburimit Bulqizë-Batër, në veri të luginës së Vajkalit

Vendburimi i kromitit Bulqize-Batër vendoset në pjesën jugore të masivit të Bulqizës dhe lokalizohet në sekuencën tektonike të nivelit të mesëm të ndërthurjes faciale harcbugit-dunitik (Shallo M., Kote Dh., Vranaj A., Premti I., 1989). Në ndërtimin gjeologjik të vendburimit marrin pjesë këto lloje shkëmbore: harcburgitet, dunitet dhe seria damarore e përfaqësuar nga piroksenite, dunite e gabropegmatite. Pjesa veriore (zona e Vajkalit) është e mbuluar nga depozitimet kuaternare të përfaqësuar nga deluvionet e proluvionet me trashësi nga 20-130m. Vendburimi i kromitit Bulqizë-Batër është i tipit podiform dhe ka marrëdhëniet konkordante të trupave xeherorë me shkëmbinjtë anësorë. Kontaktet janë të prerë, por jo rrallë ato janë graduale, me zhvillim të gjerë të duniteve kromifere. Ndërthurja "**dunit-trup kromiti"** zhvillohet deri në 10 metra trashësi. Ky vendburim ka shtrirje VP-JL, rënie jugperëndimore dhe është zbuluar nga prerja tërthore –29 (veriperëndim) deri ne prerjen tërthore LXXVII (juglindje), me një gjatësi në shtrirje 2650ml, ndërsa vendburimi Batër përben pjesën JL të tij, prej prerjes tërthore –37 (VP), deri në prerjen tërthore XLV (JL), me një gjatësi në shtrirje 1750ml. Vendburimi i kromit Bulqizë-Batër zhvillohet në drejtim të rënies, deri 1500ml. Trashësia e trupit xeheror luhatet nga 0.3-0.5-30 metra. Përmbajtja e Cr_2O_3 luhatet nga 21.29 deri 54.77 %. Xeherorët kromitikë paraqiten me tekstura masive, me pikëzime, brezore e nodulare, por predominojnë

*Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Tiranë
Email: dashamirg61@gmail.com; dashamirg@yahoo.com

ato me pikëzime mesatare, të dendura e masive. Xeherori është i tipit metalurgjik (magmakromit). Minerali i kromit është xeheror i pasur me përmbajtje mesatare 42.1% Cr_2O_3.Një prerje tipike e vendburimit të Bulqizës jepet me poshtë ku pasqyrohet aksi i antiklinalit të përmbysur me krahët e zhvillimit të trupave xeheror.



Fig. 1 *Prerje tërthore tipike e vendburimit të Bulqizës, ku pasqyrohen antiklinali me krahët e tij të rrudhosur*

Të dhënat e para mbi vazhdimin e mineralizimit në veri jepen në vitet 1970 (Dede et al.,1970).

Sipas autorëve të mësipërm lugina e Vajkalit ka origjinë tektonike dhe ndan strukturën antiklinale të masivit të Bulqizës në dy pjesë (pjesa jugore dhe pjesa veriore). Gjysma jugore e antiklinalit të Bulqizës, (sipas thyerjes tërthore të Vajkalit) është e nënvendosur thellë, nën gjysmën tjetër veriore. Këtë çvendosje e vërteton zhytja e fortë gjatësore e skajit verior të strukturës xeherore të vendburimit kromitik të Bulqizës.



Foto 1 *Miniera e Bulqizës (zona-D) ku zhvillohet aktiviteti minerar, lugina e Vajkalit.*

Autorët e studimit (Dede et al., 1969) mbi bazën e rilevimeve gjeologo-strukturore të zonës Bulqizë-Batër dhe periferive të saj (Fig. 2) si dhe informacionit gjeologjik të marrë nga zhvillimi i punimeve të shfrytëzimit në minierën e kromit Bulqizë-Batër dhanë mendimin e zhvillimit të mineralizimit në veri. Sipas kësaj ideje, lugina e Vajkalit jepet si një zonë tektonike me shtrirje verilindje-jugperëndim dhe rënie juglindore. Kjo zonë tektonike ka spostuar vazhdimin verior të mineralizimit, duke e spostuar atë në verilindje. Ndryshimi i elementëve strukturorë në pjesën veriore të luginës së Vajkalit autorët e japin si një fenomen rrudhosje, (fleksurë në planin e shtrirjes f) dhe zhvillimin e mineralizimit në veri e japin me idenë e ngritjes së strukturës së bashku me mineralizimin e kromit nga zona tektonike e parashikuar në veri të luginës së Vajkalit. Rritjet e këndit të zhytjes se vendburimit të kromit Bulqizë-Batër në drejtim të veriut nga disa gradë, ne gati vertikal, autorët e shpjegojnë me faktin ***se gjysma jugore e antiklinalit të Bulqizës, (sipas thyerjes tërthore të Vajkalit) është e nënvendosur thellë, nën gjysmën tjetër veriore.***

Kërkesave në rritje për krom të pasur pas vitit 1985,i parapriu studimi tematik i vitit 1987 nga autorët Çina et al. (1987a), të cilët përgjithësuan:

- Punimet e shfrytëzimit të minierës së kromit Bulqizë, në veri dhe thellësi nga vitet 1970-1987 si dhe ato të kërkimit-zbulimit të kryer nga miniera.
- Punimet gjeologjike (shpimet e kryera) në luginën e Vajkalit, për kërkimin-zbulimin e vazhdimësisë të vendburimit të kromit Bulqizë.
- Punimet e kërkim-zbulimit të kryera në veri të masivit të Bulqizës në objektet e kromit Kreshtë, Zabeli, Kodra e Lerës, Shkolla, Maja e Bregut etj.
- Në këtë përgjithësim tematik të autoreve jepet ideja e zhvillimit të mineralizimit të kromit në veri të luginës së Vajkalit. Lugina e Vajkalit interpretohet si një bërthame sinklinale tërthore me gjerësi rreth 3000 ml, krahu verior i kësaj përkulje mbi bazën e të dhënave nga shpimet strukturore supozohet të ngrihet drejt veriut me kënd rreth 50º (shih prerjen gjatësore më poshtë, Fig. 2). Brenda kësaj bërthame strukturore sinklinale, vazhdimësinë e trupit xeheror e kërkojnë me tre variante:
  1. Varianti i parë për shtrirje të trupit xeheror drejt lindjes me fleksurë, harta 1:25 000.
  2. Varianti për spostim në perëndim të vazhdimësisë së vendburimit Bulqizë-Batër.
  3. Varianti për spostim të vogël në lindje të vazhdimësisë të vendburimit Bulqizë-Batër.
- Mbi bazën e këtij studimi u projektua dhe u hap edhe traverbangu i Kreshtës në kuotën H-1050 metër me gjatësi 1182ml. Në metrin e 942 është hapur traversa majtas me gjatësi 450ml dhe djathtas me gjatësi 500ml. Traversa djathtas në intervalin 88-88.50ml, ka takuar një trup kromi të varfër me trashësi 0.5ml. Në traversat majtas dhe djathtas janë kryer punime shpimi për të kontrolluar tre variantet e zhvillimit të mineralizimit (të cituara më lart). Në ballin e traverbangut u takua një zonë e fuqishme tektonike me trashësi mbi 20ml me shtrirje verilindje -jugperëndim dhe rënie veriperëndimore me kënd 45-52º. Në dyshemenë e kësaj tektonike duke qartë drejtimi i lëvizjes së bllokut në tavan të tektonikes drejt verilindjes me një kënd 15º dhe azimut lëvizje 70-80º. Rezultatet e shpimit të kryera nga kamerat e traverbangut kanë qenë negative. Nuk u kryen shpime në ballin e traversës djathtas, për një spostim në lindje të vazhdimit të mineralizimit Bulqizë-Batër pasi nuk ishte parashikuar në projekt dhe nuk mendohej për një spostim të madh në lindje.



Fig. 2 *Prerja gjatësore skematike ku jepet ideja e zhvillimit të mineralizimit në veri të luginës së Vajkalit. (Çina A. et al., 1987b; Dede et al., 1968).*



Fig. 3 *Planimetria e traverbangut të Kreshtës ku jepet gjatësia, travesat si dhe kamerat nga ku janë kryer punimet e shpimit, nga projekti (Çina A. et al., 1987b) realizuar nga Ndërmarrja Gjeologjike Bulqizë (1988-1994)*

METODOLOGJIA E PËRDORUR

Në kuadër të studimit "Vlerësimi i potencialit krom-mbajtës në masivin ultrabazik të Bulqizës, perspektiva e vendburimeve kryesore dhe objekteve në drejtim të shtrirjes, në krahë dhe në thellësi" të ndërmarrë nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptarë (Gega et.al, 2019-2021) u azhurnuan:

- Punimet e shfrytëzimit të minierës së kromit Bulqizë, në veri dhe thellësi nga viti 1987-2020 si dhe të gjitha punimet e kryera nga subjektet private në veri të luginës së Vajkalit deri në Selishtë.
- U dokumentua traverbangu i Kres-htës (H-1050) ku u fiksuan zona tektonike në veri të luginës së Vajkalit me trashësi mbi 20 m e cila lidhet me tektonikën e takuar në sipërfaqe, gjatë punimeve fushore (2019-2020) në kuadër të këtij studimi. Spostimi i blloqeve në tavan të kësaj tektonike është ne verilindje (Foto 2).

Foto 2 *Dyshemeja e zonës tektonike millonitike e takuar në traverbangun e Kreshtës*

- Dy traverbangët e Kreshtës nuk kanë takuar trupin xeheror (vazhdimin verior të vendburimit të Bulqizës) por traversa djathtas ka takuar një trup xeheror të varfër me përmbajtje 12-18% ne intervalin 48.0-48.50ml. Ky mineralizim i varfër në pjesën jugore të vendburimit te Bulqizës (Dhoks-Batër) vendoset 250-300ml i spostuar në plan dhe disnivel nga trupi kryesor i vendburimit Bulqize-Batër (objekti Maja e Shinit).
- Traverbangu i Shengjunit (H-372) i hapur nga kompania AlbChrome sh.p.k, ka takuar një zone tektonike e supozuar në pjesën jugore të luginës së Vajkalit me një trashësi mbi 100-150m dhe rënie JL siç ishte parashikuar në studimin tematik në fund të vitit 1970, nga autoret (Dede et al., 1970).
- Vrojtimet e kryera gjatë viteve (2019-2020) në pjesën veriore të masivit të Bulqizës japin elementë të lineacionit (kënd zhytje dhe azimut zhytje) të njëjtë me idenë e zhvillimit te mineralizimit në veri nga autorët e studimit tematik në fund të vitit 1987 (Çina A. et al., 1987b). Kjo e vërtetuar në trupat e kromit të pjesës veriore si Zabeli i Koçit, Shkolla, Kreshtë, Kodra e Lerës, Maja e Bregut si dhe struktura rrotull objekteve të përmendura kanë kënd zhytje 38-55°(jugore) (Foto 3).



Foto 3 *Elemente lineacioni në pjesën veriore të luginës së Vajkalit, sipas aksit ku pritet vazhdimi i mineralizimit.*

